



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Fizioterapi”, me profil “Teknika Rehabilitimi”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti Europian i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Genc Burazeri
2. Prof. As. Irena Saço Kola

Korrik/2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi”, profili “Teknika Rehabilitimi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapise (Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Fizioterapi”, profili “Teknika Rehabilitimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 649 datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim i parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2020-2021)	9 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve: (2019-2021);	18 Student
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi” është program i ciklit të dytë që ofrohet nga Universiteti Europian i Tiranës, i hapur në vitin akademik 2019-2020, me Urdhërin e Ministrit Nr. 649, datë 11.10.2018.

Programi organizohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizoterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, dhe realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi”, profili “Teknika Rehabilitimi”. Departamenti ka përgatitur formën dhe suplementin e diplomës të cilat janë pjesë e dosjes së akreditimit, dhe do të miratohen pranë QSHA pas përfundimit të akreditimit, sipas akteve ligjore në fuqi.

Programi Master i Shkencave në “Fizioterapi” ka si qëllim të përgatisë profesionistë të fushës së rehabilitimit në përmirësimin e cilësisë së jetesës të pacientëve të cilët i drejtohen shërbimeve të specializuara fizioterapeutike. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij profili është analiza e detajuar e protokolleve rehabilituese, sipas teknikave bashkëkohore bazuar në hulumtime dhe të dhëna shkencore. Programi synon të përmirësojë mendimin kritik të studentit dhe të sigurojë rritje profesionale në lidhje me fushat rehabilituese të neurologjisë, ergoterapisë, teknikave fizioterapeutike dhe ekzaminimit të pacientit.

Në mbështetje të programit të studimit, Universiteti ka ngritur sallat e praktikës dhe laboratorët për zhvillimin e lëndëve bazë, posaçërisht Laboratori i Fizoterapisë i pajisur me shtetërit e manipulimit, skeleti në formë mulazhi si dhe posterat me specifikime të pamjeve anatomike, etj., janë mjetet adekuate për demonstrimin dhe vënien në praktikë të njohurive të trajtuara. Universiteti e mbështet programin e studimit, edhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione dhe qendra spitalore, më konkretisht: QSUT, Spitali Universitar i Traumës, Poliklinika Gjermane, Spitali Amerikan, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Spitali Salus, kryesisht për realizimin e praktikave klinike.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Grup ekspertësh: Prof. Asoc. Irena KOLA dhe Prof. Dr. Genc BURAZERI, si ekspertë të jashtëm të vlerësimit për këtë program studimi.

Ekspertët e vlerësimit, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UET dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi”, profili “Teknika Rehabilitimi”.

Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga UET për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në Universitetin Europian të Tiranës në datën 25 dhe 28 Mars 2022. Gjatë kasaj dite u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, drejtuesit e Fakultetit, Departamentit, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takime u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të: Burimeve Njerëzore, Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zhvillimit të Projekteve, Zyra për Kujdesin ndaj Studentëve, si dhe vizitë në Bibliotekën e Universitetit dhe ambjenteve mësimore.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi” me profil “Teknika Rehabilitimi”, ofruar nga Unviersiteti Europian i Tiranës.

Më datë 21.06.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/71Prot., datë 21.06.2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 05.07.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr 78/101 Prot., datë 05.07.2022


GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Në lidhje me Standardi I.4/ Kriteri 1 Standardi II.5/ Kriteri 2:

Vlerësimi i ekspertëve: Standardi I.4/ Kriteri 1: “...Për sa më sipër, GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme të qëndrueshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit, por pa gradat perkatese, per stafin akademik ashtu sic e kerkon Ligjit i Arsimit te Larte.”

Standardi II.5 / Kriteri 2: “...GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar ne mesimdhenie , nuk ka gradat e duhura (Prof, Prof.Asoc, Dr) sipas Ligjit te Arsimit e Larte,....”

Sqarim nga Universiteti: Konstatohet se vlerësimi për këto dy standarde është ulur në “Përmbushen kryesisht” për të njëjtën arsye, mungesa e stafit me grada e tituj në fushën e



fizioterapisë. Ndërkohë që kemi të bëjmë me një fakt, dëshirojmë të vëmë në dukje se mungesa e personelit akademik me grada e tituj në fushën e fizioterapisë është e përgjithshme sa i takon vendit tonë, dhe nuk lidhet me programin e UET. Pavarësisht interesit dhe përpjekjeve të institucionit për të punësuar staf me grada e tituj, rezulton se programet e fizioterapisë i orientojnë të diplomuarit e kësaj fushe kryesisht drejt karrierës profesionale dhe jo asajakademiqe, ndaj edhe plotësimi i këtyre standardeve është i vështirë për shkak të mungesës së këtij personeli në vend. UET është përpjekur që ta kompensojë këtë mangësi duke përzgjedhur personel akademik të mirëkualifikuar dhe me përvojë profesionale në fushën e fizioterapisë, çka është konfirmuar edhe nga GVJ.

Përgjigja e GVJ: GVJ sic është shprehur dhe në Standartin I.4 / Kriteri 1 Standardi II.5 / Kriteri 2, konstaton se vlerësimi për këto dy standarde është në “Përmbushen kryesisht” për arsye të mungesës së stafit me grada e tituj në fushën e fizioterapisë.

Jemi dakort me sqarimin e bërë nga institucioni, se kjo problematik e mungesës së personelit akademik me grada e tituj në fushën e fizioterapisë është e përgjithshme në vendin tonë, e konstatuar edhe në IAL të tjera jo publike dhe që nuk lidhet vetëm me programin e UET. Në kushtet e situatës aktuale, ku në vendin tonë nuk janë hapur programe të ciklit të tretë “Doktoraturë”, që nga 2013, ne si GVJ nuk mohojme stafin akademik mësimdhënës me tituj dhe grada sipas ligjit, por mungesa me tituj dhe grada të personelit akademik për lëndët profesionale, gjithashtu ne si GVJ mendojmë që kjo situatë në këtë institucion nuk vjen si pasojë e mangësive të këtij institucioni, por pavarësisht këtyre konstatimeve ne vlerësojmë aktualitetin në këtë institucion dhe prandaj mendojmë që vlerësimi i këtij standarti të jetë “Përmbushen kryesisht”.


Në lidhje me Standardi II.2:

Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Vlerësimi i ekspertëve: Në përgjigje të kriterëve të këtij standardi, vlerësimi i GVJ është pozitiv përveçse në Kriterin 4: “Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.”, ku vlerësimi i ekspertëve përmbillet me komente mbi kualifikimin e personelit të angazhuar në programin e studimit: “...Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit

Master i shkencave në Fizioterapi në dy vitet e fundit, është me tituj akademik Prof, Prof Asoc, dhe grada shkencore Doktor Shkencash, dhe kualifikim Msc”.

Koment nga Universiteti: Vëmë në dukje se standardi II.2 i referohet personelit akademik të njësisë kryesore dhe asaj bazë, dhe jo personelit akademik të angazhuar në programin përkatës të studimit, informacion që u referua në standardet I.4 dhe II.5, si më sipër. Lutemi të rishikohet vlerësimi për shkallën e përmbushjes së Standardit II.2, pasi sa i takon Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë që është përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Fizioterapi”, këto njësi i përmushin kërkesat dhe standardet ligjore për numrin dhe kualifikimin e stafit akademik (Ref.Nr. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit).



Përgjigja e GVJ: GVJ duke vlerësuar komentin e bërë nga institucioni , përsa i përket shkallës së përmbushjes së Standardit II.2, mendon se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë që është përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Fizioterapi”, këto njësi i përmushin kërkesat dhe standardet ligjore bazuar referencave përkatëse.

Në këto kushtet ne si GVJ konstatojmë dhe mendojmë që ky standart të ndryshojë “Përmbushet plotësisht”.

Në lidhje me Standardi II.4 / Kriteri 6 (konstatimi për përdorimin e literaturës në gjuhë të huaj)

Standardi III.3 / Kriteri 4 (konstatimi për përdorimin e literaturës në gjuhë të huaj) dhe **Kriteri 5** (konstatimi për mungesën e literaturës fizike në gjuhën shqipe në Bibliotekë)

Standardi IV.4 / Kriteri 2 (konstatimi për mungesën e literaturës fizike në gjuhën shqipe në Bibliotekë)

Koment nga Universiteti: Pranohet konstatimi i GVJ për mungesën e literaturës në gjuhën shqipe dhe nevojën e pasurimit të fondit të Bibliotekës, rezultat i publikimeve të pakëta në gjuhën shqipe në fushën e fizioterapisë. Gjithsesi, sikurse e kemi vëmë në dukje edhe gjatë vizitës në institucion, dhe në RVB, në përputhje edhe me aktet rregullatore të UET, sa i takon programeve të ciklit të dytë, sikurse është edhe programi “Master i Shkencave” në “Fizioterapi”, nisur edhe nga kriteri ligjor që studentët e këtyre programeve duhet të dëshmojnë në hyrje njohjen e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Europian, literatura mbi të cilën duhet të mbështetet mësimdhënia në lëndët e programit kërkohet të jenë publikime të shtëpive botuese prestigjioze perëndimore, çka garanton ofrimin e njohurive të përditësuara dhe rrit cilësinë e ofrimit të programit të studimit. GVB këtë element e ka renditur tek pikat e forta të programit dhe i qëndrojmë këtij vlerësimi. Sa më sipër, do i vinte përshtat programit Bachelor në Fizioterapi, por jo një programi Master i Shkencave. Në kushtet kur është e pamundur që një vend si Shqipëria të përditësojë në kohë përkthimet e kushtueshme të literaturës në fushat e studimit, mbështetja në literaturën e përkthyer në shqip do të ndikonte negativisht në zhvillimin cilësor të çdo kurrikule të programeve Master i Shkencave, duke marrë në konsideratë dinamikën e zhvillimeve të fundit në fushat e studimit. Për rrjedhojë, do të vlerësonim rishikimin e vlerësimit përfundimtar sa i takon përmbushjes së standardit III.3 (Ref. RVB: Përfundimet e vlerësimit; Ref.Nr. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës - Pika A.III.4.2.3).

Përgjigja e GVJ: GVJ lidhur me komentet e bëra nga institucioni në lidhje me Standardin II.4 / Kriteri 6, Standardi III.3 / Kriteri 4 , kriteri 5, Standardi IV.4 / Kriteri 2 (konstatimi për përdorimin e literaturës në gjuhë të huaj, mungesës së literaturës në gjuhën shqipe etj), ka **konstatuar mungesën e literaturës bazë në gjuhën shqipe të lëndëve profesionale**, pavarësisht se dihet që që studentët e këtyre programeve dëshmojnë në hyrje njohjen e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Europian, por GVJ, **nuk mohon praninë e literaturës në gjuhë të huaj, si literaturë ndihmëse**, mbi të cilën duhet të mbështetet mësimdhënia, çka garanton ofrimin e njohurive të përditësuara dhe rrit cilësinë e ofrimit të programit të studimit. GVJ i qëndron vlerësimit të bërë në draft.

Në lidhje me Standardi IV.3/ Kriteri 3 (sugjerim për pasurimin e laboratorëve të fizioterapeutisë me materialet didaktike të nevojshme)

Koment nga Universiteti: Sa i takon infrastrukturës në dispozicion të programit të studimit, duke marrë në konsideratë edhe numrin e studentëve të regjistruar në program, konfirmojmë se laboratorët e mjetet didaktike në to, janë të mjaftueshme dhe plotësojnë më së miri nevojat për zhvillimin e orëve mësimore. Po ashtu, shfrytëzohen maksimalisht dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet spitalore për akomodimin e praktikave profesionale (Ref.Nr. 34.1 – 34.8). Sigurisht, në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme, universiteti ka bërë edhe planifikimet përkatëse për nevojat që duhet të adresohen kur të ndërtohet kampusi i ri universitar.

Përgjigja e GVJ: GVJ shpreh dakortësinë me komentin e bërë nga institucioni, për përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi të institucionit dhe të laboratorit të fizioterapisë në vecanti në të ardhmen.

Në lidhje me Standardi IV.6 / Kriteri 5

Vlerësimi i ekspertëve: “Universiteti European ka një histori relativisht të gjatë në arsimin e lartë në vend. Ai ka dëshmuar se garanton qëndrueshmërinë financiare të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Për shkak se aktualisht institucioni mbështetet në tarifatat e studentëve për realizimin e programeve të studimit, rekomandojmë që në të ardhmen të diversifikohen mundësitë e sigurimit të të ardhurave, përmes aplikimit në projekte e sigurimin e granteve fitimprurëse që mbështesin veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit për këtë program studimi

Koment nga Universiteti: Në vlerësimin e ekspertëve nuk konstatohen elementë që të çenojnë përmbushjen e ndonjë prej kriterëve në përmbajtje të këtij standardi, madje në përgjigje të Kriterit 5, konstatojmë se vlerësohet që Universiteti dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare dhe zotëron kapacitete për përmirësimin dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Për rrjedhojë rekomandimi i ekspertëve edhe pse është i qëndrueshëm dhe përputhet me objektivat e Universitetit dhe FSHMT, ka të bëjë me përmirësimin e mëtejshëm në këtë drejtim, por nuk ka pse të pasqyrohet si rekomandim në funksion të përmbushjes së standardit. I lutemi GVJ të rishikojë shkallën e përmbushjes së këtij standardi, për sa kohë vetë afirmimet e tyre në vlerësimin e kriterëve konfirmojnë se standardi përmbushet plotësisht.

Përgjigja e GVJ: GVJ bazuar në komentet e institucionit mbi Standardin IV.6 / Kriteri 5, shpreh dakortësinë me komentin e bërë, pasi ne jemi shprehur se Universiteti dëshmon dhe garanton qëndrueshmëri financiare dhe zotëron kapacitete për përmirësimin dhe gjenerimin e të ardhurave me kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

GVJ mendon që ky standard të ndryshoj në **Përmbushet Plotësisht.**

Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi”, me profil “Teknika Rehabilitimi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE”


Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti European i Tiranës (UET) synon arritjen e standardeve më të larta akademike, mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjekësisë. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikë-bërëse në fushën e mjekësisë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që programi i studimit i ofruar nga IAL, mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. <i>(Ref. Dok. Nr. 2 Statuti UET)</i>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit të ofruara nga UET synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UET. Këto programet ofrojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare si dhe synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(Ref. Dok. Nr. 2 Statuti UET)</i>			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UET ofron programe në disa prej fushave kryesore shëndetësore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit, me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre në vazhdim, në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi Master i Shkencave në Fizioterapi ofron një mundësi formimi për studentët në fushën e fizioterapise si pjesë e rëndësishme e kujdesit mjekësor. <i>(Ref.Dok.Nr.4 Plani strategjik per zhvillimin e programit të studimit)</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, synon në formimin e shprehive të profesionit, duke i dhënë studentit njohuritë praktike dhe teorike nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit si dhe aftësisë të tyre për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës konform standarteve të njohura ndërkombëtare. <i>(Ref.Dok.Nr.4 Plani strategjik per zhvillimin e programit të studimit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2021-2025, në të cilën janë përcaktuar drejtimet strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të janë në përputhje me fushën e veprimtarisë të UET, duke tentuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësidhënies të kërkimit shkencor, me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë të shëndetit.Referuar RVB-së,Universiteti European i Tiranës ofron programe studimi që respektojnë gjithë kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe nuk bien ndesh me asnjë interes kombëtar. Programi i studimit ofrohet në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikë-bërëse në fushën e mjekësisë. Duke ju referuar RVB-së, si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit, duke synuar krijimin e një ambjenti nxitës për stafin akademik dhe studentët. <i>(Ref.Dok.Nr. 3 Plani strategjik UET 2015-2020)</i>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe Rregullorja e UET përcaktojnë objektivat akademike e kërkimore, qëllimet, misionin, mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive dhe shërbejnë si bazë për programin e studimit. Sipas dokumenteve referuese prioritet akademik është përcaktuar synimi që UET të veprojë si një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim në komunitet.GVJ shqyrtoi dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe konstatoi se sipas <i>Planit strategjik për zhvillimin e programit</i> , përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e Universitetit dhe nëpërputhje me Statutin e Universitetit. <i>(Ref. Dok. Nr. 2 Statuti UET, Qëllimi dhe Objektivat, Dok. Nr. 5 Rregullore UET,Ref.Dok.Nr.4 Planit strategjik për zhvillimin e programit te studimit)</i>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Në zbatim të Urdhrit të MASRNr. 649, datë 11.10.2018, është urdhëruar hapja e programit të studimit Master i shkencave në "Fizioterapi", me një kohëzgjatje normale prejdy (2) vitesh studimi akademike (120 ECTS). Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave, konstaton që programi i studimit Master i Shkencave në "Fizioterapi", i cili ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, si njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave MjekësoreTeknike si njësi kryesore, është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit. <i>(Ref.Dok.Nr.2 Statuti UET); (Ref.Dok.Nr. 3 Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Master i Shkencave në "Fizioterapi" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke njohur konkurrencën në tregun e punës dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabuset e lëndëve, kostatohet që ky program studimi ka për qëllim formimin e specialistëve me njohuri në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit. Fizioterapistët e diplomuar në këtë program studimi, të jenë të aftë profesionalisht të ofrojnë me ndershmëri dhe seriozitet shërbim me nivel të lartë profesional në fushën e mjekësisë. Formimi i një figure profesionale fleksibël, e aftë për t'ofruar me ndershmëri dhe profesionalizëm dijet dhe aftësitë e veta në shërbim të shëndetit të njerëzve. (Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset);(Ref.Dok.Nr.4 Objektivat e programit te studimit)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës. Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me aktivitetin konkret për ndjekjen e tregut të punës, sondazheve që kryen kjo zyrë dhe gjurmimit të studentëve alumni. Institucioni falë bashkëpunimit që ka me institucionet shëndetësore në vend, merr vazhdimisht informacione mbi nevojat dhe tregun e punës. Referuar statistikave të diplomuarve, emigrimit të tyre drejt tregut ndërkombëtar, rezulton se ende ka kërkesa për këtë drejtim profesionistësh. UET vazhdimisht është në kontakt me ofruesit e shërbimit shëndetësor, ku diskutohen kërkesat, nevojat e tyre dhe mundësitë e punësimit të studentëve.</p> <p>(Ref.Dok.Nr 17 Studimi për tregun e punës para hapjes së programit)</p> <p>(Ref.Dok.Nr.29 Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre)</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Fizioterapi" drejtohen drejtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formimit akademik dhe shkencor bashkëkohor të studentëve në fushën e fizioterapisë - Ofrimin e një diplome cilësore dhe bashkëkohore në profilet e kërkuara nga qendrat shëndetësore publike dhe private. - Të ofrojë për studentët mundësi shkëmbimi të studimeve jashtë vendit - Të realizojë profilin e teknikëve fizioterapistë të kërkuar nga tregu i punës <p>Me qëllim arritjen e këtyre objektivave, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë kosideron si prioritet rritjen e vazhdueshme të cilësisë së</p>




	<p>kurrikulave të këtij program studimi, vënien në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione kërkimore dhe qendra spitalore, realizimin e projekteve kërkimore në mbikqyrjen e stafit akademik.</p> <p>Realizimin e këtyre objektivave GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi duke analizuar kurrikulën egzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si dhe duke parë angazhimin konkret, si të personelit akademik e ndihmës, ashtu edhe të studentëve. Caktimin e një tutori studimesh, që i shoqëron studentët gjatë gjithë kohës së studimeve, GVJ e vlerëson si një gjetje me vlerë në përcelljen dhe realizimin me efikasitet të lartë të ndihmës për studentët. (Ref.Dok.Nr.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit te studimit)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimor në një fushë të caktuar.</p>	<p>UET ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. UET ka eksperiencë 3-vjeçare në programin e studimit Fizioterapi. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë/ Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Ky i fundit ka një staf akademik me formim profesional të kualifikuar dhe me grada shkencore në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë.</p> <p>Ky Fakultet për vitin akademik 2021 – 2022 ka gjithsej 26 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Doktor Shkencash, 2 janë Dr. në proces dhe 9 Asistent Lektorë me Msc; dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka gradën Doktor shkencash dhe 3 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Në krahasim nga viti i mëparshëm akademik, ku nga gjithsej 29 personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2020-2021, 21 prej tyre janë personel efektiv, ndërsa 8 personel me kontratë, rezultoi se FSHMT si fakultet i ri është duke u konsoliduar në një staf të qëndrueshëm. Kjo vërehet dhe në përbërjen e personelit akademik të departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, sidomos në tre vitet e fundit.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në dy vitet e para akademike, sipas evidences rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin 2019-2020 8 pedagogë gjithsej, ku 6 PAE, nga të cilët 2 Prof. Dr., 1 Prof As; 3 Msc, dhe 2 PAK, 1 Dr dhe 1 asistent lektor.

	<p>Raporti PAE/ PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 75% me 15%.Pedagogët efektiv mbulojnëmbi 85% të ngarkesës totale mësimore.</p> <p>- Në vitin 2020-2021 10 pedagogë gjithsej, ku 9 PAE, nga të cilët 1 Prof. Dr., 3 Dr.; 5 Msc, dhe 1PAK , asistent lektor.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezulton 90% me 10%. Pedagogët efektiv mbulojnëmbi 85% të ngarkesës totale mësimore.</p> <p>Për sa më sipër,GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme të qëndrueshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit., <i>por pa gradat perkatese , per stafin akademik ashtu sic e kerkon Ligjit i Arsimit te Larte.</i></p> <p>Ne keto kushte, GVJ mendon se pavarësisht formimit adekuat të personelit me angazhimin akademik në lëndët që mbulojnë, Universiteti është koshient për nevojën e angazhimit të personelit me kualifikimin akademik “Doktor”, dhe atë të kategorisë “Profesor”, dhe vlerësohen përpjekjet konkrete të stafit akademik për kualifikimin akademik në IAL jashtë vendit.</p> <p>(Ref.RVB – Konkluzionet e raportit)</p> <p>(Ref.Dok.Nr. 23. Të dhënat tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse)</p> <p>(Ref.Dok.Nr.02 Tabelat permbledhese -Cilesia e stafit mesimdhenes per programin e studimit, tabela nr. 6 / 12)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të Fakultetit dhe departamentit që e ofron programin. Programi i studimit Master i Shkencave ne Fizioterapi, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore.Institucioni zbaton me përpikmëri cdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.3 Statuti i UET)</p> <p>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, i cili ka kapacitetet akademike dhe logjistike për realizimin me sukses të programit mësimor.Fusha të cilës i përket Programi i Studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europiane. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, i cili është përgjegjës për ofrimin e këtij programistudimi, ofron dhe program studimi të ciklit të parë.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET)</p> <p>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit)</p>



bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti European ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. (Referuar takimeve në IAL)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit, si dhe shërbimet mjekësore vendës e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrdhënieve Ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Konkretisht institucioni ka hasur vështirësitë e realizimit konkret të disa projekteve bashkëpunimi me jashtë për shkak të situatës së pandemisë botërore si dhe për shkak të procedurave të gjata të aplikimit. (Referuar takimeve me Zyrën e Projekteve e Marrdhënieve Ndërkombëtare)
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, u konfirmua se Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Shëndetësore për realizime praktikave profesionale si : QSUT, SUT, Spitali Salus, Klinika Mjekësore Gjermane etj (Ref.Dok.Nr.34 Memorandumet e bashkëpunimit) (Takimet në IAL)
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi që Universiteti European i Tiranës ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me

bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	punëdhënësit. Ka përfunduar vetëm një cikël studimesh dhe eksperiencia është e re, por vetë departamenti ishte aktiv në mbështetjen e marrëdhënieve me qendrat spitalore/punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe organizimeve të përbashkëta. (Ref. Dok. Nr. 34 Marrëveshjet e bashkëpunimit)			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar RVB-së dhe vizitës në Institucion GVJ konstatoi se Universiteti Europian i Tiranës ka ngritur marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme kryesisht brënda vendit. Në periudhën e pandemisë Covid 19 Departamenti referon vështirësi në organizimin e plotë të disa elementëve të praktikave profesionale në Institucionet shëndetësore. Institucioni referon për strategji të mëtejshme bashkëpunimi me institucionet shëndetësore. Aktualisht në këtë program studimi janë diplomuar një brez studentësh, por UET krijon eksperiencën e duhur dhe bashkëpunimet e nevojshme për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për studentët e diplomuar. (Takimet në IAL)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes. Institucioni synon të mbështesë dhe të investojë kërkimin shkencor dhe projektet me karakter kombëtar. Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes të cilësisë së mësimdhënies. (Ref. Dok. Nr. 3.2 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025)
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni i jep kompetenca për kërkimin shkencor Fakulteteve dhe në FSHMT është formuar <i>Qendra e Kërkimeve në Shëndet Publik</i> i cili është i formuar nga 7 anëtarë. Kjo njësi ndihmon edhe në realizimin e temave shkencore të studentëve të cilët ndjekin studimet në programin e studimit Master i Shkencave në "Fizioterapi". Kjo njësi bën vlerësimin periodik të rezultateve të kërkimeve shkencore, si dhe propozon ndryshimet për përmirësime të nevojshme. (Ref. Dok. Nr. 3.2 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025); (Ref. Dok. Nr 23 Tabela për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike: Qendra e Kërkimeve në Shëndet Publik)
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion u konstatua se Institucioni bën promovimin e kërkimit shkencor duke zhvilluar konferencën 'Ditët e studimeve Shqiptare' duke e konsideruar si aktivitet të përvitshëm. Për shkak të situatës së pandemisë Covid19 aktivitete të tilla janë me ritme më të ngadalta.

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

14


	<i>(Ref.Dok.Nr 3.1 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020); (Vizita në IAL)</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Stafi i UET respekton etikën dhe ndershmërinë akademike në ushtrimin e aktivitetit shkencor. Botimet shkencore janë të pasqyruara dhe online me të dhënat e nevojshme për të gjithë kërkuesit. <i>(https://uet.edu.al/konferenca/)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.56 Kodi i Etikës)</i>			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Revista Medicus (https://uet.edu.al/medicus/) në UET është një nga botimet e cila mund të shfrytëzohet jo vetëm për botimin e artikujve shkencorë të stafit akademik apo studiuesve të njohur, por edhe nga studentët e ciklit të dytë në prezantimin e punimeve të tyre në bashkëpunim me stafin akademik. <i>(Ref.Dok.Nr.3.2 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TËDYTE MASTER I SHKENCAVE

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi është i strukturuar në 2 vite akademike, i organizuar në 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 15 lëndë me modulet përkatëse të ndara sipas 2 viteve shkollorë (10 lëndë në vitin e parë; 5 lëndë në vitin e dytë). Krahas 15 lëndëve që parashikohen në planin mësimor, përfshihet edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktikaprofesionale /internship. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Argumentohet se në kurrikulën e programit, kategoria e veprimtarive formuese C (lëndë ndërdisiplinore/integruese/grup-lëndë me zgjedhje) është konceptuar sipas hapsirave ligjore të lejuara për kohën e miratimit të programit, kur MSH Fizioterapi është ofruar me profilet: Teknika Rehabilitimi; Rehabilitim Sportiv (Referuar UMASR Nr. 649, datë 11.10.2018, Ref.Dok.Nr. 54). Gjatë takimeve në institucion, GVJ u njoh me faktin se për shkak të interesimeve të studentëve të regjistruar në program (3 studentë, viti 2019-2020; 9 studentë, viti 2020-2021; 6 studentë, viti 2021-2022, Ref.Dok.Nr. 27 Cilesia në hyrje dhe dalje për programin, tabela e regjistrimeve për tre vitet e fundit), ai ka patur aktivitetin më të mirë në Teknika Rehabilitimi. Në rast se në të ardhmen, Departamenti ofron vetëm profilin Teknika Rehabilitimi, sygjerohet që kurrikula e programit të plotësohet më tej në kategorinë C, sidomos në drejtim të aktivizimit të kursit special (Honour Course). Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores, vërehet që programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimit të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo discipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor i programit Msc. Fizioterapi);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave" synon formimin e shprehive të veçanta në</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi siguron formimin e shprehive të veçanta në fushën e teknikave</p>

një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh..	fizioerapeutike. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor i programit Msc. Fizioerapi);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit "Master i shkencave" jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioerapi janë gjithëpërfshirëse, duke u kombinuar si lëndët që ndikojnë në formimin profesional të cilat synojnë të japin shprehje e nocione të avancuara të fushës, ashtu edhe lëndët e formimit akademik si metodologjia e kërkimit shkencor dhe menaxhimi shëndetësor. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor i programit)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të parashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizioerapi" jep njohuritë themelore në lëndët e formimit bazë të cilat shërbejnë për formimin e përgjithshëm akademik. Këto lëndë janë shpërndarë kryesisht në vitin e parë akademik. Më tej, lëndët e tjera të formimit profesional shërbejnë për thellimin e kompetencave profesionale të studentit aktual, por edhe të profesionistit të ardhshëm. Në vlerësimin e syllabuseve të lëndëve profesionale vihen re zhvillim me kompetencë i temave të ndryshme të cilat do të shërbejnë në rritjen e aftësisë së profesionistit të ardhshëm për të zgjidhur probleme të ndryshme në fushën e dhënies së shërbimit të tij specifik. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor Master i shkencave ne Fizioerapi);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lëndëve në Master i Shkencave ne Fizioerapi)</i>
Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioerapi janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Programi i studimit Master i Shkencave në "Fizioerapi" është një program studimi i ciklit të dytë, ka një kohëzgjatje normale prej 2 vitesh akademike dhe plotësohet me 120 ECTS. Forma e studimeve të programit të ciklit të dytë të studimit Master i shkencave në "Fizioerapi" është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është shqip. Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma "Master i Shkencave " në Fizioerapi. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor Master i shkencave ne Fizioerapi)</i>
Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: <ul style="list-style-type: none">▪ kategoria A - 10%▪ kategoria B - 50%▪ kategoria C - 15%▪ kategoria D - 10%



	<p>▪ kategoria E – 15 %</p> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mesimor Master i shkencave ne Fizioterapi);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.14.4 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Ky Fakultet për vitin akademik 2021 – 2022 ka gjithsej 26 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Doktor Shkencash, 2 janë Dr. në proces dhe 9 Asistent Lektorë me Msc; dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka gradën Doktor shkencash dhe 3 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Në krahasim nga viti i mëparshëm akademik, ku nga gjithsej 29 personel akademik në Fakultetin e Mjekësore Teknike për vitin akademik 2020-2021, 21 prej tyre janë personel efektiv, ndërsa 8 personel me kontratë, rezultojnë se FSHMT si fakultet i ri është duke u konsoliduar në një staf të qëndrueshëm. Kjo vërehet dhe në përbërjen e personelit akademik të departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, sidomos në tre vitet e fundit.</p> <p>Nga sa më sipër rezultojnë se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës ka përfituar akreditimin si institucion me vendim të Bordit të Akreditimit Nr 12, datë 07.04.2017. Ky akreditim është i vlefshëm deri në datën 06.04.2022. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përbushin të gjitha detyrimet ligjore që lindin nga ky proces në funksion të arsimimit cilësor.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.23 Te dhënat për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.54.5 Certifikatë akreditimi institucional 2017)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është njësia kryesore akademike e UET që koordinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: ww.ascal.al

18

<p>organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Departamentin i Imazherisë - Qendra e Kërkimeve në Shëndet Publik. <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti ka kombinim të stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterpisë, i cili ofron programin Master i Shkencave në Fizioterapi, plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.2 Statuti i UET; Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesëshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka në total 26 pedagogë, nga të cilët 22 janë PAE dhe 4 janë PAK. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka në total 11 pedagogë nga të cilët 8 PAE (3 Dr; 5 Msc) dhe 3 PAK (1 Dr; 2 Msc). Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, i cili ofron programin Master i Shkencave në Fizioterapi, plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>(Ref.Dok. Nr.0.2 Tab permbledhese)</p> <p>(Ref.Dok.Nr.23 Te dhënat për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.);</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës ka angazhuar staf akademik duke respektuar specialitetin e lëndëve/ moduleve dhe me synim përcjelljen e informacionit akademik në përputhje me ekspertizën e lektorëve. Personeli akademik me kohë të plotë mbulon mbi 70% të ngarkesës akademike në auditor. Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezultoi në 90% me 10%. Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master i shkencave në Fizioterapi në dy vitet e fundit, është me tituj akademik Prof, Prof Asoc, dhe grada shkencore Doktor Shkencash, dhe kualifikim Msc.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mjekësore. Departamenti ka 2 personel akademik me MSC të cilët angazhohen kryesisht në realizimin e praktikave mjekësore. Departamenti ka angazhuar pedagoge me gradën shkencore Doktor në ndjekjen e projekteve studimore të studentëve që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET); (Vizita në IAL)</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë kanë caktuar një koordinator të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.36 Vendimi përemërimin e kordinatorit të programit)</p>

<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Në bazë të shqyrtimit të dokumenteve, koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesit e njësisë kryesore. Koordinatori po ashtu ka për detyrë dokumentimin e çdo informacioni që ka lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.36Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit MSH është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterpisë/FSHMT zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të aksesueshme nga çdo anëtar i personelit akademik.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2Plani mësimor;Ref.Dok.Nr.7 Rregullorja e programit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Fizioterapi” është organizuar nëdy vite shkollore me 4- semestra.</p> <p>Lëndët janë të klasifikuara në veprimtari formuese nga A deri nëE dhe përmbajnë elementët të ndryshëm të mësimdhënies që sigurojnë një formim cilësor të fizioterapistëve të ardhshëm.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi është i strukturuar në 2 vite shkollore dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 18 lëndë të ndara sipas 2 viteve shkollore (10 lëndë në vitin e parë; 5 lëndë në vitin e dytë). Krahas 15 lëndëve që parashikohen në planin mësimor, përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika profesionale.</p> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 12 ECTS (10%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 60 ECTS (50%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 18 ECTS (15%)

	<p>- Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 12 ECTS (10 %)</p> <p>- Kategoria E (detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 18 ECTS (15%)</p> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, me profil Teknika Rehabilitimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Argumentohet se në kurrikulën e programit, kategoria e veprimtarive formuese C (lëndë ndërdisiplinore/integruese/grup-lëndë me zgjedhje) është konceptuar sipas hapsirave ligjore të lejuara për kohën e miratimit të programit, kur MSH Fizioterapi është ofruar me profilet: Teknika Rehabilitimi; Rehabilitim Sportiv (Referuar UMASR Nr. 649, datë 11.10.2018 , Ref.Dok.Nr. 54). Gjatë takimeve në institucion, GVJ u njoh me faktin se për shkak të interesimeve të studentëve të regjistruar në program (3 studentë, viti 2019-2020; 9 studentë, viti 2020-2021; 6 studentë, viti 2021-2022, Ref.Dok.Nr. 27 Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin, tabela e regjistrimeve per tre vitet e fundit), ai ka patur aktiv vetëm profilin Teknika Rehabilitimi. Në rast se në të ardhmen, Departamenti ofron vetëm profilin Teknika Rehabilitimi, sygjerohet që kurrikula e programit të plotësohet më tej në kategorinë C, sidomos në drejtim të aktivizimit të kursit special (Honour Course).</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2Plani mësimor Master i Shkencavenë Fizioterapi)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.4 Plani mësimor sipas veprimtarive formuese)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor është një tabelë e detajuar me të gjithë elementët e ngarkesës mësimore që përfshijnë leksionet, seminarët, labororet, ushtrimet dhe praktikat klinike.</p> <p>Detyrimet akademike që duhet të përmbushë secili student që të klasifikohet në provimin përfundimtar të modulit/lëndës dhe mënyra e pikëzimit në varësi të ngarkesës është përcaktuar me vendim senati dhe përshkruhet në syllabusin e cdo moduli.</p> <p>Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë:</p> <p><i>Për lëndët e tipologjisë I</i></p> <p>Detyra praktike – 60%</p> <p>Provimi përfundimtar -60%</p> <p><i>Për lëndët e tipologjisë II</i></p> <p>Seminare – 10 %</p> <p>Provimi I ndërmjetëm – 30 %</p> <p>Detyrë kursi – 20 %</p> <p>Provimi përfundimtar- 40 %</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i></p>

<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e Studimit Master i Shkencave në Fizioterapi duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve të rinj, UET rekruton kandidatët sipas meritokracisë bazuar nga kërkesa e departamentit për numrin e studentëve që mund të rekrutohen në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë. <i>(Vizita në IAL)</i>.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, kanë të përfshirë të gjithë elementët informues lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS. <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit nuk kapasur ndryshime që nga licensimi i tij megjithëse është mbyllur një cikël i plotë studimi, kjo edhe në respekt të parashikimeve ligjore ku pritet akreditimi i programit për të reflektuar ndryshimet e mundshme brenda masës 20%.</p> <p>Universiteti ka mekanizma të brendshme të vlerësimit të programit, si në nivel departamenti, duke përfshirë kontributin e aktorëve të ndryshëm, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koordinatorit të Programit (Aneks: Detyrat e koordinatorit) - Mbledhjeve me Bordin e Tregut të Punës / HR Club (kontribut i përfaqësuesëve të tregut të punës) - Mbledhjeve departamentale/dekanat (kontribut i secilit anëtar të stafit akademik) - Mbledhjeve të hapura me studentët (kontribut i studentëve) <p>Po ashtu, funksionojnë dhe mekanizma në nivel unviersiteti, të cilat kryejnë aktivitete në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit, si: KSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.36 Vendimi per miratimin e koordinatorit te programit, Detyrat e Koordinatorit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.6 Mbi funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.13 Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 1 kredit leksion është e konvertuar me 10 orë leksion në auditor dhe 1 kredit seminar është e konvertuar në 7 orë mësimore në auditor. 1 kredit praktikë është e konvertuar në 25 orë mësimore apo praktike. 1 kredit ka në total 25 orë (në auditor +individuale).</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi; Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimet e moduleve\lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale mundësojnë thellimin e njohurive, aftësim për punë të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit akademik si dhe lëndë të thellimit të njohurive profesionale.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi)</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfitimit të njohurive akademike, studenti zhvillon në mënyrë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga ortopedia, traumatologjia, protetika, urgjencat, neurologjia, kirurgjia dhe rehabilitimin për secilin nga drejtimet etj.</p> <p>Të gjitha këto njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e fizioterapisë në çdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Po ashtu, studenti merr informacione të mjaftueshme edhe në drejtim të formimit akademik të tij.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe thellimit të njohurive profesionale dhe akademike.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit; Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit;</i></p>


dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me intitucione që ofrojnë shërbime fizioterapeutike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14.4 Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, Ref.Dok.Nr.34 Marreveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale)</i></p>
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit. Në rregulloren e universitetit, kriter për literaturën bazë të përdorur është se ajo duhet të jetë e mbështetur në më shumë se një botim bazë, kryesisht në gjuhë të huaj dhe sipas rastit të veçantë edhe vendase (Ref. Dokumenti nr. 39, Mbi parimet e ndërtimit të progrmait të lëndës). <i>Në zbatim të rregullores, pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaj. Pavarësisht kësaj, literatura në gjuhën shqipe e këtij programi ka problemet e veta në mungesën e teksteve në gjuhën shqipe.</i> Institucioni është i vetëdijshëm për kufizimet e numrit të teksteve/literaturës në gjuhën shqipe, prandaj rekomandohet të merren iniciativa për shqipërimin dhe botimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira të cilat hulumtohen e shfrytëzohen nga stafi akademik i programit duke u përcjellë literaturë me përditësimet përkatëse.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr. RVB – Konkluzionet e raportit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve; Lista e literaturës në biblioteke)</i></p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi me profil Teknika Rehabilitimi, garanton përfitimin e dijeve jo vetëm në fushën e rehabilitimit, por gjithashtu synon ta pajisë studentin me njohuri dhe shprehje komplementare që do t'u shërbejnë atyre në punësim. Ai kombinon teorinë dhe praktikën, duke synuar nxitjen e studentëve për përvetësimin e kompetencave e pavarësisht profesionale në fushën e fizioterapisë. Po ashtu, të diplomuarit përfitojnë njohuritë e nevojshme shkencore, vlerat etike dhe aftësitë profesionale të rëndësishme për fushën e rehabilitimit fizioterapeutik, duke thelluar më tej studimin e disiplinës dhe të kërkimit shkencor specifik. <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve)</i></p>
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar kështu mundësi për studimet të avancuara nga ana e studentëve.</p> <p>Lëndët që synojnë formimin akademik të studentëve janë me element të plotë dhe të avancuar që shërbejnë për thellimin e njohurive profesionale dhe kjo</p>

	mund të sjellë lehtësira edhe në vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit Master i Shkencave; Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lëndëve)</i>			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. <i>(Ref.Dok.Nr.34 Marrëveshje bashkëpunimi UET)</i>			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë bën përpjekje për kombinimin e veprimtarisë së formimit teorik dhe shkencor dhe kjo është arritur nga një koordinim i mirë mes drejtuesit të departamentit, koordinatorit të programit të studimit dhe stafit akademik. <i>(Vizita në IAL)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master i shkencave në Fizioterapi në Universitetin Europian të Tiranës në dy vitet e fundit, është me tituj akademik Prof, Prof Asoc, dhe grada shkencore Doktor Shkencash, dhe kualifikim Msc.</p> <p>Për sa i përket stafit akademik të profilit fizioterapeutik të angazhuar në këtë program, ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. U vu re nga takimet, bisedat, CV dhe dokumentacioni i akreditimit, se stafi ka bërë përpjekje konkrete për kualifikim akademik në IAL jashtë vendit (njëri prej tyre vijon studimet e ciklit të tretë në Universitetin e Shkupit).</p> <p><i>GVJ është e qartë për situatën e bllokimit prej disa vitesh të mundësive për kualifikimin e mëtejshëm dhe fitimin e gradave dhe titujve akademik në IAL në vendin tonë, gjithsesi rekomandojmë që kur të rihapen programet e ciklit të tretë të studimeve për profilin fizioterapeutik, Institucioni të</i></p>



krijoj mundësinë e stimulimit dhe pjesëmarrjes së stafit të brendshëm në program.

Nga sa më sipër, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie pavarësisht përputhshmërisë së ekspertizës dhe profilit profesional e mësimdhënës, ka nevojë të përmirësojë treguesit në përmbushje të kërkesave ligjore për kualifikimin akademik.

Personeli akademik i brendshëm (PAE) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim :

	2019-2020	2020-2021
Prof. Dr	2	-
Prof As	1	1
Dr/PhD	-	3
MSC	3	5
Totali	6	9

Personeli akademik i jashtëm (PAK) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim

	2019-2020	2020-2021
Prof. Dr	-	-
Prof As	-	-
Dr/PhD	1	-
MSC	1	1
Totali	2	1

Vihet re se për sa i përket ngarkesës mësimore, në të dy vitet plotësohet kriteri ligjor për PAE që ka mbështetur me mbi 70% ngarkesën mësimore.

(Ref.Dok.Nr.0.2 Tabelat permbledhese -Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit,tab 7);Të dhëna për stafin, tab 6)

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e


Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi”, ***GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në mesimdhënie , nuk ka gradat e duhura (Prof, Prof.Asoc, Dr) sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, pavarësisht perkushtimit maksimal për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë, refruar takimit me studentet dhe stafin gjate vizites ne institucion.***

moduleve mësimore të programit të studimit.	<i>(Ref.Dok.Nr.20 CV e personelit akademik)</i> <i>Vizita ne institucion</i>			
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli i kualifikimit profesional dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Master i Shkencave në "Fizioterapi" është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. <i>(Ref.Dok.Nr.20 CV e personelit akademik)</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si objekt shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta akademiko-shkencore si dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. Stafi i teknikëve fizioterapistë pranë institucioneve të bashkëpunimit angazhohet në mbikëqyrjen dhe zhvillimin me sukses të praktikave klinike. Në të gjitha rastet kur praktika zhvillohet jashtë UET, angazhohet koordinatori i programit për organizimin dhe stafi i institucioneve për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. <i>(Ref.Dok.Nr.35 Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Universiteti Europian i Tiranës disponon një infrastrukturë laboratorike për programet me orientim mjekësor. Pavarësisht se institucionet kanë qënë të mbyllura, stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, kanë prezantuar në kohë reale zhvillimin e punëve laboratorike nga mjediset e këtij kampusi. Stafi akademik i mjekëve dhe teknikëve fizioterapistë të angazhuar në këtë program studimi sigurojnë mirëmbajtjen e ambjentëve didaktike dhe realizimin me sukses të orëve laboratorike të parashikuara në këtë program studimi. Për shkak të karakteristikave të këtij programi studimi, laboratorët për formimin karakterizues të studentëve, gjenden si në ambjentet e UET, gjithashtu edhe pranë institucioneve shëndetësore. Megjithatë gjatë vizitës së GVJ u konfirmua që institucioni ka bërë të mundur dhe implementimin e teknologjisë dixhitale virtuale në realizimin e orëve praktike të disa lëndëve të formimit profesional. <i>(Vizita në IAL)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6				
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë pavarësisht kushteve të pandemisë botërore është angazhuar në konsultime dhe bashkëpunime me ekspertë të fushës. Drejtuesi i departamentit, gjatë vizitës së GVJ,parashtrori propozimet e tij në lidhje me përmirësimin e programit të studimit të cilat janë të realizueshme.</p> <p><i>(Takimet në IAL)</i></p>			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Institucioni është përpjekur vazhdimisht të përfshijë aktorë të ndryshëm në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve. Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti). Institucioni programon politika dhe ndërmer masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.2 Statuti UET, neni 30, pika 30.4)</i></p>			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës së GVJ në Institucion na u paraqitën element që konfirmojnë qëndrimin në kontakt me student të diplomuar për të marrë prej tyre propozime që përmirësojnë programin e studimit.</p> <p>Vlen për tu theksuar se ky program është i ri dhe ka vetëm një brez studentësh të diplomuar.<i>(Vizita në IAL)</i></p>			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	<p>Në rastet kur lind nevoja për organizimin e programeve të posaçme, të cilat kanë fokus zhvillimin dhe përmirësimin e institucioneve, UETështë gjithmonë i hapur për ti përmbushur këto nevoja, duke përshtatur dhe riorganizuar programet, gjithmonë konform respektimit dhe zbatimit të ligjit.</p> <p><i>(Takimet në IAL)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Misionii Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë është t'u japë studentëve edukim cilësor duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por dhe tek njohuritë praktike profesionale duke vënë theksin në specializimin e tyre të mëtejshëm. Objektivat e këtij program studimi mbështesin objektivat madhorë të Institucionit të Arsimit të lartë UET. <i>(Ref.Dok.Nr.4 PlaniStrategjik për zhvillimin e programit)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, si pjesë e FSHMT bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik të përfshirë në këtë program. Kjo realizohet përmes planifikimit të ngarkesës mësimore fillim të çdo viti nga Përgjegjësja e Departamentit duke patur parasysh përputhshmërinë e ekspertizës së stafit akademik me lëndët që planifikohen të mbulojnë. Lidhur me kërkimin shkencor, në nivel fakulteti me mbështetje nga zyrat administrative për kostot financiare, hartohen planet e integruara të kërkimit shkencor, të cilat pasohen nga planet individuale të stafit akademik sipas interesave të tyre për fushën e veçantë të kërkimit shkencor. Në fund të çdo viti akademik, anëtarët e stafit u konstatua se raportonin për punën e tyre kërkimore, pjesëmarrjet në projekte, etj. <i>(Ref.Takimi me Përgjegjësen e Departamentit dhe Dekanin)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.3.2 Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit - Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit përfshin studentët e interesuar në studime kërkimore, studime shkencore apo projekte të ndryshme të departamentit. Studentët e universitetit vazhdimisht nxiten e motivohen për të marrë pjesë në studime, projekte e aktivitete kërkimore. Këto kryhen edhe nën mbikqyrjen e pedagogëve udhëheqes, të cilët kanë tituj e grada shkencore dhe janë të specializuar në ndjekjen e këtyre studimeve. <i>(Takimet me studentet)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi i studimit është akoma i ri dhe ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, por Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjatë vizitës së GVJ konfirmon fokusin e këtij departamenti për hartimin e një programi që zbaton politikën studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. <i>(Ref.Dok.Nr.4 Planit Strategjik për zhvillimin e programi; Takimet ne IAL)</i>
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni i UET dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.



financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Për shkak se aktualisht institucioni mbështetet në tarifën e studentëve për realizimin e programeve të studimit, rekomandojmë të diversifikohen mundësitë e sigurimit të të ardhurave, përmes aplikimit në projekte e sigurimin e granteve fitimprurëse që mbështesin veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit. (<i>Ref.Dok.Nr.2 Statuti UET</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, u vu re përpjekja e departamentit për realizimin e projekteve kërkimore shkencore të reja, bazuar në eksperiencat e mëparshme si institucion.Për këtë, UET, FSHMT dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë kishin realizuar disa bashkëpunime kryesisht në drejtim të kërkimit shkencor. (<i>Ref.Dok.Nr.3.1 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020</i>)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Ka një angazhim të plotë të njësive përgjegjëse për tupërgjigjur kërkesave për analiza, studime e projektë.Institucioni nxit përfshirjen e stafit akademik si dhe studentëve në realizimin e këtyre objektivave. (<i>Ref.Dok.Nr.55 Ditët e studimeve shqiptare;</i> <i>Ref.Dok.Nr.3.2 Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025</i>)
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Departamenti dhe fakulteti përfshihen në mënyrë aktive në organizimin dhe impelmentimin e projekteve shkencore të nivelit të konferencave, seminare apo seancave të shkëmbimit të eksperiencave. Të tilla janë Ditët e Studimeve Shqiptare (https://uet.edu.al/konferenca/), konferenca që zhvillohen 1 herë në vit zakonisht në muajin Maj për stafin akademik (DSSH) dhe në muajin Tetor për studentët (DSSH Junior). Pjesëmarrja e studentëve në këtë konferencë, konsiston në prezantimin e punimit më të mirë të temës së diplomës. Në programet dhe në përmbledhjet e punimeve nga konferencat ndër vite, të publikuara dhe në website e UET, GVJ konstaton dhe punime të stafit të angazhuar në programin e studimit. Po ashtu dhe në programin e DSSH Junior, konstatohet studente e programit MSH Fizioterapi dhe tematika e prezantuar në konferencë (https://uet.edu.al/wp-

	<p>content/uploads/2021/12/Conference-Programme-DSSH-JUNIOR-2021.pdf).</p> <p>Referuar RVB, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë zhvillon leksione të hapura në programin Master me të ftuar drejtues të kompanive dhe institucioneve shëndetësore, duke përçuar praktikën dhe eksperiencën e tyre tek studentët.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.55 Ditet e studimeve shqiptare; RVB)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës për shkak të specifikës së situatës së pandemisë covid 19, ka adaptuar përdorimin e metodologjisë online të mësimdhënies. Megjithatë universiteti ka ndërtuar një strategji zhvillimi për përmirësimin e mësimdhënies dhe me elementë të caktuar të tij po punon dhe aktualisht. Gjithashtu UET ka hartuar dhe materialin udhëzues për metodat e mësimdhënies në distancë (online).</p> <p>Gjatë vizitës në Universitet GVJ u njoh me investimin e kryer në ndërtimin e laboratorit virtual (VR), si një nga metodat inovative të mësimdhënies që zbatohet dhe në programet e fushës së shkencave mjekësore. Për zbatimin e këtyre metodave, stafi akademik kishte marrë trajnimet e duhura dhe nga partnerët e projektit ku ishte përfituar ky laborator.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.5.3 Rregullore tranzitore per mesimin online) (vizita ne IAL)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Njësia e brendëshme e sigurimit të cilësisë është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të mësimdhënies. Indikatorët e përdorur nga kjo njësi reflektohen në formularin e performancës së pedagogut. Kjo njësi përgatit raportin përfundimtar me evidentimin e problematikave eventuale dhe synon të evidentojë praktika efektive në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>(Ref.Dok.Nr.30.1 Plani i Veprimit KSBC)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në fund të semestrit dhe në mënyrë periodike i kërkohet studentëve të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndëve. Paraqiten pyetje të shumta me qëllim vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Nga ana tjetër studentët janë vazhdimisht në kontakt me koordinatorin e programit për paraqitjen e problematikave të tyre.</p> <p>Rezultatet e pyetësorit janë analizuar dhe vlerësuar me qëllim përmirësimin e indikatorëve dhe treguesëve të institucionit. Në fund bëhet raporti përfundimtar. <i>(Ref.Dok.Nr.8 F. VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Pyetësori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga elementët e rëndësishëm që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Rezultatet përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe i komunikohen drejtuesit të departamentit, i cili merr hapat e nevojshëm bazuar në raportin e KSBC. <i>(Ref.Dok. F. VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,</p>	<p>Rezultatet e përftuara nga pyetësori, si dhe nga vlerësimi i performacës reflektohen në dosjen individuale të personelit akademik. Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira si dhe inkurajon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: ww.ascal.al

32


nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	ndryshme trajnimi, leksione të hapura etj. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitetet ndërkombëtare dhe inkurajon mobilitetin e stafit në bazë të Projeksit Erasmus+.			
	<i>(Ref.Dok. F. VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Departamenti organizon trajnime apo workshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Ne kuadër të mësimin online institucioni ka realizuar webinarë apo leksione të hapura online.</p> <p>Ndihmë në këtë drejtim jep Platforma e edukimit në distancë e cila krijojnë gjithashtu mundësi për prezantimin e veprimtarive laboratorike që zhvillohen në institucion. Kjo metodë ndihmon studentët të ndjekin në kohë reale dhe të jenë interaktive gjatë zhvillimit të saj. <i>(RVB)</i></p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	<p>Personeli akademik i përzgjedhur nga institucioni ka përgatitje të lartë akademike. Gjithshtu ai përpiqet të identifikojë sa më herët çështjet problematike të studentëve dhe kontribuon në zgjidhjen e tyre në bashkëpunim me koordinatoren e departamentit dhe përgjegjësin e departamentit.</p> <p>Me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, institucioni organizon vazhdimisht trajnime për personelin akademik me tematika pedagogjike.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.20CV e stafit akademik)</i></p> <p><i>(Vizita në institucion)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile, përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kurse dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj.</p>

të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	<i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit. <i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në përpunime me natyrën dhe profilin e lëndëve. Zhvillimi i veprimtarive nëpërmjet platformës së edukimit në distancë kanë qënë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Këtu vlen të përmendet dhe roli i koordinatorit të programit i cili reflekton ankesat e arsyetuara të studentëve në biseda konstruktive me pedagogët për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>(Ref.Dok.Nr.33 Te dhënat për trajnimet profesionale)</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminarat. Studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore, etj. Kjo shumëllojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Plani mësimor;Ref.Dok.Nr.19 syllabuset)</i>			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <i>(Vizita në institucion)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithëinfrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies dhe shkencor kryhet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka kampusin e tij të pajisur me klasa leksionesh, seminare dhe laboratore.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të pajisura me pajisjet më moderne, duke përfshirë projektorë, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet në të gjithë ambientin universitar për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën moderne etj.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në të gjithë universitetin është i mundur akses në rrjetin kompjuterik të shkollës, sistemet e menaxhimit, dhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Studentët kanë akses të palimituar në platformën e mësimin online LMS. Përveç menaxhimit të mësimdhënies platforma e LMS shërben edhe për marrjen e shënimeve, njoftimeve të ndryshme. Studenti mund të përdorin këtë platformë për dorëzimin e projekteve apo detyrave të kursit.</p> <p>Lidhur me infrastrukturën e brendshme, institucioni disponon salla leksionesh seminare, të pajisura me kompjutera dhe projektorë, gjithashtu u jepet dhe akses në internet nëse është e nevojshme.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve me formim mjekësor. Literatura prezente në Bibliotekë është e botuar 10 vitet e fundit. Vlen për tu theksuar se Institucioni zotëron 22 tituj librash fizikë të cilat ndihmojnë studentët kryesisht në njohuritë e përgjithshme mjekësore. Institucioni zotëron libra fizikë të cilët ndihmojnë dhe orientojnë studentët në përgatitjen e duhur të temës së diplomës. Institucioni zotëron dhe 10 libra online të cilët lidhen ngushtë me programin studimit bazë dhe literaturë ndihmëse në ambiente të bibliotekës së Universitetit Europian. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Por ka vetëm literaturë në gjuhë të huaj dhe në përgjithësisht në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti Europian i Tiranës gjithashtu ka akses në një numër bibliotekash on-line. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage& Ebsco si dhe Questia.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.45 Inventari i teksteve fizikë për fushën e programit)</i></p> <p><i>(Inventari i teksteve elektronikë për fushën e programit)</i></p>

<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka funksionon me sistem elektronik dhe aksesohet si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët.</p> <p>Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës gjendet kryesisht në gjuhën angleze. <i>Biblioteka zoteron shumë pak tituj shqip në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, për vetë specifikën e programit.</i></p> <p>(Ref.Dok.Nr.45 Inventari I teksteve fizike per fushën e programit) (Ref.Dok.Nr.45.1 Mbi funksionimin e bibliotekës)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Paralelisht me bibliotekën fizike, biblioteka është abonuar për një periudhë 5 vjecare në libraritë elektronike Sage& Ebsco si dhe Questia e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.45.1 E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron një bazë laboratorike digjitale moderne. Kjo është një element bashkëkohor që integron realen me virtualen për konkretizimin praktik të mësimin. Si dhe orët laboratorike praktike organizohen në ambiente të pajisura me bazën didaktike për zhvillimin e praktikës. Në Godinën A, janë të vendosura dhe Laboratorë mësimorë specifikë për programin, me shtretërit dhe pasqisjet e nevojshme.</p> <p>Për shkak të specifikes së programit të studimit pjesa më e madhe e praktikave profesionale zhvillohet jashtë territorit të universitetit. (Vizita ne IAL)</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UET–LMS është sistemi kryesor i komunikimit dhe ndërveprimit në institucion i cili aksesohet nëpërmjet internetit. Personeli akademik, administrativ dhe studentët zhvillojnë të gjitha veprimtaritë nëpërmjet këtij sistemi qoftë proceset mësimore apo veprimtaritë e tjera administrative e kërkimore.</p> <p>Po ashtu platforma përdoret edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, webinarë, prezantime, diskutime etj.</p> <p>Në sistem, studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj.</p> <p>Të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet sistemit online LMS. (Ref.Dok.Nr.46 Manuali i përdorimit të sistemit UMIS/ LMS)</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët dhe pedagogët përdorin sistemin e brendshëm të komunikimit nëpërmjet përdorimit të adresave elektronike të fakultetit, google drive. Por sistemi më i rëndësishëm i komunikimit është ai i mësimdhënies së ofruar nga Universiteti LMS. Ky sistem ka rezultuar një sistem i mirë komunikimi si dhe mësimdhënies.</p> <p>(Ref.Dok.Nr.5.2 Rregullore tranzitore mbi vijimin e procesit akademik)</p>

	Ref.Dok.Nr.46 Të dhënat per platformën LMS)			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Programi i studimit përfshin mbrojtje diplome me përgatitjen e një teme të vecantë nga cdo student. Kjo temë realizohet në bashkëpunim, asistencë dhe kordinim të stafit akademik <i>(Ref.Dok.Nr.10 -B.II Mbi punimin e diplomes dhe disertacionit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, UET ka krijuar Komisionin e Sigurimit të Brendëshme të Cilësisë (KSBC). Kjo njësi ka funksionin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë. Po ashtu, kjo njësi luan rolin edhe në monitorimin dhe përmirësimin e programeve mësimore, në vlerësimin e performancës së stafit akademik, vjen në ndihmë edhe të studentëve. Kjo njësi është përgjegjëse edhe për hartimin e raporteve vjetore ku pasqyrohen problematikat e dala gjatë vitit akademik si dhe rekomandimet për kapërcimin e tyre. <i>(Ref.Dok.Nr.8 -F. VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Nga shqyrtimi i rregullores së funksionimit të programit të studimit vërehet që Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Master i Shkencave në Fizioterapi. Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit Msc. Fizioterapi)</i>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është struktura bazë, e cila në bashkëpunim edhe me strukturën e koordinorit të programit është përgjegjës për mbështetjen e eksperimentimin apo zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Metodatat kryesore përfshijnë përfitimn e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale apo në grup, leksione të hapura apo praktika laboratorike. <i>(Vizita në institucion)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të	Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit te CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale vullnetare, seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor.

ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>(Ref.Dok.Nr.20 CV e stafit akademik); (vizita ne Institucion); (Ref.Dok.Nr.28.1 Mobility agreement UET)</i>			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizojnë në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga trajnues ndërkombëtarë, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit te universitetit. <i>(Ref.Dok.Nr.28.1 Mobility agreement UET)</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në Statutin e Universitetit si dhe në Planin Strategjik të Departamentit, stafi akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi dhe stafi mbështetës janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. <i>(Ref.Dok.Nr.28.1 Te dhënat mbi projektet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare)</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë vizitës në Institucion u prezantuan aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës akademik trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse . <i>(Ref.Dok.Nr.28.1 Mobility agreement UET) (Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Institucioni ka eksperiencë të mëparshme disavjecare në angazhimin e lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të programeve të studimit, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies. Referuar informacionit në RVB e programit, Universiteti angazhon bashkëpunëtorët dhe partnerë me të cilët ka marrëveshje, si lektorë të huaj dhe në takime për shkëmbimin e përvojave të tyre. Ndër aktivitetet e zhvilluara ndër vite janë: “Si të jemi lektorë të suksesshëm” (Janar 2016); “How to publish and research” (Qershor 2017); “UET Research” (Gusht 2018). Këto aktivitete u konfirmuan dhe nga diskutimet në takimin me stafin dhe Përgjegjësen e Departamentit. <i>(Ref.Dok.Nr.55.1 Kalendari i aktiviteteve UET; RVB; Vizita në institucion)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë kryesore kanë hartuar dhe zbatojnë aktet rregullatorë të cilat koordinojnë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive.</p> <p>Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara edhe në faqen e Internetit të Universitetit. Rregullorja e insitucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. UET ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien online dhe testimin e njohurive.</p> <p>Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës onlinesiguron informimin e plotë të studentëve.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.19Syllabysset e lendes);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.5.2 Rregullore provimesh on line);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.5.3 Udhëzues për provimet online)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënit të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj.</p> <p>Syllabuset e lëndeve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.19Syllabysset e lendes);</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve në programin studimor, si dhe takimit me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes shumatoreve të formave kryesore të vlerësimit si: provim i ndërmjetëm, prezantim, laborator, provim përfundimtar, pjesëmarrje aktive.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e Lëndëve)</i> <i>(Takimi me studentet)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare. Provimet e ndërmjetme apo vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi sipas syllabusit përkatës. Programi i studimi ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në aftësitë profesionale. <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit të studimit);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.14 Programi i studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online. UET ka hartuar edhe platformën e provimeve online, e cila u përdor në masë gjatë situatës së pandemisë Covid-19. Pedagogët e përdorin këtë platformë dhe për zhvillimin e kuizeve dhe detyrave të kursit.</p> <p>Për të siguruar transparencën në zhvillimin e provimeve, ato kryheshin me sekretim dhe zbardheshin në fund të korrigjimit të pedagogut, nga sekretaria mësimore. Gjithashtu, referuar RVB aplikohet dhe sistemi elektronik “clean scoring” në bashkëpunim me Albanian American Development Foundation (ADF), për lëndë të ndryshme në nivelin bachelor e master.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore programi studimi),</i> <i>(Ref.Dok.Nr.14 Programi i studimit)</i> <i>(Vizita në institucion; RVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Provimet vlerësohen nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mesimor. Vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë.</p> <p><i>(Ref.Dok. Nr. 7 Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5.3.3)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të</p>	<p>Gjatë realizimit të provimit, studenti pajiset me barkodin individual nga sekretaria mësimore. Vlerësimi i studentëve është anonim. Studenti gjatë provimit online monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik apo ndihmës akademik si dhe nga sekretaria mësimore. Në fund të provimit student përfiton pikët përkatëse të grumbulluara të cilat më pas konvertohet në notë.</p>


monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	<i>(Ref. Nr. 7.2 Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6.e)</i>			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit i cili ka të drejtë ti dijë ato. Nëfundtë ballafaqimit me studentët, pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të studentit. <i>(Ref.Nr.7.2 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve)</i>			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. Gjithashtu, UET që prej vitit 2015, implementon sistemin antiplagjiature (<i>Turnitin Ephorus</i>), në mënyrë që punimet e studentëve të mund të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas, për plagjiaturë përpara se të marrin vlerësimin final nga pedagogët, apo komisionet e vlerësimit përkatës. <i>(Takimet ne IAL)</i>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e përfundimit të vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura edhe në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. <i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET, neni 27)</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentëve u ofrohet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti ngre një komision të posaçëm i cili rivlerëson tezën në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky proces dokumentohet në departament. <i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET)</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Nuk referohen raste ankimi nga ana e studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve përfundimtare dhe nuk ka pasur asnjë ankimindrejtuar Përgjegjësit të departamentit. <i>(RVB); (Takimi me studentet)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapii ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Plani i programit mësimor rendit lëndë e module të cilat përputhen me nivelin e ciklit të dytë të programit të studimit. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Programi Master i Shkencave në “Fizioterapi” ka si qëllim të përgatisë profesionistë të fushës së rehabilitimit në përmirësimin e cilësisë së jetesës të pacientëve të cilët i drejtohen shërbimeve të specializuara fizioterapeutike. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij profili është analiza e detajuar e protokolleve rehabilituese sipas teknikave bashkëkohore bazuar në hulumtime dhe të dhëna shkencore. Programi synon të përmirësojë mendimin kritik të studentit dhe të sigurojë rritje profesionale në lidhje me fushat rehabilituese të neurologjisë, ergoterapisë, teknikave fizioterapeutike dhe ekzaminimit të pacientit.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Msh Fizioterapi, pika 3.3)(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane dhe sociale janë përfshirë tema të caktuara brenda syllabuseve të ndryshëm në kurrikulën e këtij program. Gjithashtu në Institucion ka një kabinet të teknologjisë dixhitale, e cila aksesohet lehtësisht nga studentët e këtij programi.Referuar dokumenteve të akreditimit, syllabuset e programit janë të hartuara dhe në gjuhën angleze. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve konstatohet se literatura e përdorur gjendet kryesisht në gjuhën angleze, bazuar dhe në Rregulloren e Universitetit, duke bërë të mundur përvetësimin e koncepteve dhe risive që lidhen me fushën e studimit. Staf i akademik dhe studentët konfirmuan në takimet e zhvilluara me ta, se materialet e leksioneve, literaturës dhe ato ndihmëse për temat mësimore, u vihen në dispozicion nga pedagogët në platformën online LMS.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14 Programi i studimit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.19. Syllabueset e programit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përfundim të cdo lëndepërmbledhen,analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti sipas syllabuseve të cdo lënde. Bazuar në këto informacione të mbledhura, pedagogu i lëndës duhet të rishikojë cdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e e zhvillimit të mësimin, sygjeron ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.14 Programi i studimit)(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton</p>	<p>Zhvillimi i procesit mësimor bëhet duke përcuar informacionin online. Mësimi ka interaktivitet dhe komunikim të rrjedhshëm me studentin, gjë e cila shërben dhe për ngritjen e problemeve të ndryshme si dhe orientimin e studentëve për zgjidhjen dhe implementimin e tyre në sferën praktike.</p>




studentët për implementimin e tyre.	<i>(Takimi me studentët e programit të studimit)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik mbështetet nga Departamenti dhe Universiteti për realizimin e aktiviteteve të ndryshme si leksione të hapura, konferenca, workshope etj. Këto leksione zhvillohen si në kuadër të lëndëve të caktuara të programit të studimit, ashtu edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik. Gjatë orëve të hapura me të ftuar special dhe institucione të cilat paraqesin zhvillimet më të reja në fushën e teknologjisë dhe mjekësisë. <i>(Ref.Dok.Nr.3Trajtime profesionale);(Takimi me stafin akademik)</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Master i Shkencave në Fizioterapi kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët mjekësore, si dhe në praktikat profesionale. <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e Lëndëve)</i>
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Master i Shkencave në Fizioterapi. Në takimet që GVJ zhvilloi me studentët dhe stafin, u pyet dhe mbi metodat e zhvillimit të mësimit, ku u konstatua se në diskutimet gjatë leksioneve dhe seminareve të zhvilluara, studentët prezantoheshin me raste klinike dhe situata të ndryshme pacientësh të shoqëruara edhe me materiale audio-vizuale. Demonstrime të tilla ishin të evidentuara dhe paraqitura dhe në leksionet e hapura dhe workshopet me lektorë të ftuar, specialistë të fushës. <i>(Ref.Dok.Nr.14 Kurrikula e programit të studimit)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e Lëndëve)</i> <i>(Vizita në institucion)</i>
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndër-kombëtare. <i>(Vizita ne IAL)</i>
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera. Studentët e FSHMT prej vitesh marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit. <i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e UET)</i>
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies	Ekspierenca e mëparshme në mobilitetin e stafit akademik si dhe studentëve ka angazhuar Universitetin nërealizimin marrëveshjeve të vazhdueshme



me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	bashkëpunimi. Universiteti ka pasur vëshitrësi aktuale të Pandemisë virale botërore në implementimin e plotë të tyre, por procedurat janë shtyrë për një periudhë më të përshtashme. Megjithatë zyra e projekteve dhe marrëdhënieve ka rol të rëndësishëm për ndihmën ndaj studentëve. <i>(Ref.Dok.Nr 3.1 Strategjia e kërkimit shkencor 2017- 2020)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. <i>(Ref.Dok.Nr.10 Mbi punimin e diplomes dhe disertacionit)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Informacionet dhe udhëzimet për mbrojtjen e diplomës janë vënë në dispozicion të studentëve dhe është publikuar dhe në faqen online. Pedagogët përgjegjës përgatisin një program mbështetës për provimin përfundimtar. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar. <i>(Ref.Dok.Nr.19 Syllabuset e lendeve);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.14.2 Programi i studimit)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Punimi i diplomës bëhet duke përgatitur material shkencor, i cili përfshin njohuritë e marra gjatë të dy viteve akademike me orientimin kryesor drejt informacionit shkencor të dobishëm. Në rastet kur studentët zhvillojnë provim përfundimtar, sipas rregulloreve së sistemit të vlerësimit, Komisioni i posaçëm e bazon përmbajtjen e programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë: 80% lëndë nga Kategoria B, dhe 20% lëndë nga Kategoria C. Lista e pyetjeve hartohet nga Departamenti dhe shpallet për studentët brenda muajit Mars të çdo viti akademik. <i>(Ref.Dok.Nr.10 Mbi punimin e diplomes dhe disertacionit)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final	Nga vizita në universitet mësohet që stafi akademik përgjegjës për provimin e përgjithshëm përfundimtar është koordinatori i programit i cili


apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	bashkërendon punën dhe ndihmon si stafin akademik ashtu edhe studentët që diplomohen. <i>(Vizita ne IAL)</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Programii studimit e realizon pothuajse të gjithë pjesën e praktikave profesionale dhe laboratorike në klinika fizioterapie dhe ambjente spitalore, të cilat janë të lokalizuara në institucionet shëndetësore me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi. Universiteti asiston këto studentë në marrëveshje me udhëheqësit klinikë, të cilët ndjekin studentët gjatë praktikave profesionale, por edhe nën vëzhgimin e koordinatorit të programit. <i>(Takimi me studentët e programit të studimit)</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogët përgjegjës për studentët dhe temat e tyre të diplomës punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato në përgatitjen për provimin përfundimtar. Udhëheqësi në seancat metodologjike duhet të trajtojë çështje të tilla si: a. Përcaktimin shkencor të objektit të studimit; b. Diskutimin e dobisë së punimit; c. Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; d. Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; e. Ndërtimin e strukturës së punimit; f. Përcaktimin dhe shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi; g. Hartimin e punimit të diplomës; Debatimin e përfundimeve të studimit etj. Udhëheqësi është garantues i cilësinë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studenti, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës. <i>(Ref.Dok.Nr.10 Për punimin e diplomës, pika B.II.5.2. dhe B.II.8.8)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimit të diplomës. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. <i>(Takimi me studentët e programit të studimit)</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë dhe kompletimin e 120 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundime studimeve, studenti pajiset me Diplomën përkatëse, certifikatën e notave si dhe me Suplementin e Diplomës. Sipas nenit 40 të Rregullores së UET, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me

	suplementin e diplomës (në gjuhët shqip dhe anglisht), të firmosura nga Dekani dhe Rektori. <i>(Ref.Dok.Nr.15 Model diplome dhe suplementi)</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Dokumenti i diplomës do të shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës të firmosur nga organet drejtuese të Fakultetit dhe i nënshkruar nga Rektori. Studenti në përfundim të studimeve, gëzon të drejtën të pajiset me kopje zyrtare të dokumentave të programit të studimit, sic janë përmbajtja e syllabuseve apo plan-programi i studimeve. Ky i fundit gjendet i publikuar dhe në faqen zyrtare të internetit nga ku studentët mund ta printojnë në çdo kohë. Për t'u pajisur me dokumentet zyrtare të programit, studentit duhet të kryejë një kërkesë pranë Departamentit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Programi është ende i ri, por në rregulloren e Programit të studimit theksohet që UET arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe rast pas rasti bazuar në kërkesat e studentit lëshohen vërtetime me qëllime të ndryshme. <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UET, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale strukturën përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit “Fizioterapi” e cila është Zyra e Burimeve Njerëzore. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcaktohen midis të tjerash llojin e dokumentacionit (në formë shkresore dhe/apo elektronike) që mbahet pranë institucionit dhe personin përgjegjës. Në lidhje me dokumentat që përmban dosja specifike e stafit akademik dhe administrative, institucioni vepron në bazë të udhëzimit për përmbajtjen e dosjes së stafit. Përveç informacionit personal, institucioni ruan edhe të dhëna në lidhje me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të stafit akademik ndihmësakademik dhe administrativ. Këto të dhëna shërbejnë më pas për analiza, raporte të ndryshme që kryhen institucioni në kuadër të vlerësimit të performancës dhe vetëvlerësimit për procese të ndryshme.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr. 11 Dokumenti G Rregullore për Burimet Njerëzore)</i> <i>(Ref.Dok.Nr. 44.1 Dhe 44.2 Format i dosjes së stafit akademik PAE dhe PAK)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita online, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe rregulloren e rekrutimeve të UET.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr. 11 Dokumenti G Rregullore për Burimet Njerëzore)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Përditësimi i të dhënave kryhet çdo vit akademik dhe janë të hapura, me konkurs dhe synojnë përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zoterojnë grada shkencore. Institucioni disponon udhëzime dhe dokumenta të hartuar që provojnë procedurat dhe kriteret për rekrutimin e personelit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit https://uet.edu.al/rreth-uet/, rrjetetsociale <i>(Shembull thirrje për staf akademik (Ref. Nr. 11.1)</i> dhe në gazetën Liberale.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web të UET (si edhe në rrjetet sociale të UET) dhe janë në përputhje me kërkesat dhe specifikat të programit të studimit. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr. 5 Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 22)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e ciklit të dytë të studimit në “Fizioterapi”. Dokumenti i vënë në dispozicion nga institucioni, tregon se stafi akademik në përgjithësi ka një ngarkesë mësimore që është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, e cila është e përshtatshme dhe mund të realizohet prej tyre në mënyrë profesionale. Stafi ka në dispozicion infrastrukturën laboratorike dhe pajisjet bashkëkohore që zbatohen sot në shëndetësi në vendin tonë, të cilat janë siguruar edhe falë bashkëpunimit me partnerët.</p> <p><i>(Ref.Dok. Aneks Tabela 4 e ngarkesës mësimore)</i> <i>(Ref.Dok.Nr. 42 Infrastruktura në funksion të programit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UET për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. Personelit akademik u ofrohej mundësia e publikimit pa kosto në revistën që boton FSHMT, pjesëmarrja pa kosto në të gjitha konferencat që organizon vetë UET.</p> <p>Ndërkohë, gjatë këtij takimi stafi akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë institucionit kur ata i kishin bërë kërkesë këtij të fundit.</p> <p><i>(Takimet me stafin e programit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të</p>	<p>GVJ konkludon se ka përpjekje dhe aktivitete të zhvilluara në funksion të kualifikimit dhe zhvillimit të stafit, trajnimit mbi metoda inovative dhe dëshmon për pjesëmarrje në aktivitete dhe konferenca të ndryshme. Në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe:</p>



personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>(1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike.</p> <p>Gjithashtu, kryhen trajnime nga Zyra e TIK, për përdorimin e sistemit LMS, për pedagogët, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij.</p> <p>(Ref.Dok.Nr. 46.4 Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS)</p>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>GVJ konkludon si nga dokumentacioni i dorëzuar ashtu dhe gjatë takimit se ka përpjekje maksimale nga institucioni për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Universiteti ka një rregullore mbi procedurën e menaxhimit të Burimeve njerëzore, ku përcaktohen kriteret e rekrutimit dhe punësimit. Procedurat ekzekutohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, dhe bëhen publike në faqen e webit. Shpallja për punësim përmban kriteret për stafin që do të rekrutohet, në bazë të kërkesave që Departamenti përcjell pranë Zyrës BNJ.</p> <p>(Ref.Dok. Aneks Tabela 12 e stafit të programit) (Ref.Dok. 11. Dokumenti G Rregullore për burimet njerëzore) (Ref. Dok. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike.</p> <p>Institucioni zotëron një kabinet, kryesisht anatomie, të teknologjisë virtuale. Prej themelimit të tij, deri në fund të vitit akademik 2020-2021, UET ushtroi aktrivitetin e tij në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H.1 dhe për vitin akademik 2021-2022, e në vazhdim, gjendet në kampusin e ri universitar me adresë Rruga “Xhanfize Keko”, Nd. 56, në Tiranë. Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike 130. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m². Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave, Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m², dhe 353 vende.</p> <p>(Vizita ne institucion)</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Hapësirat didaktike si klasat për leksione dhe seminare janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik.

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në aspektin praktik edhe për shkak të situatës së COVID 19, shumica e proceseve janë zhvilluar përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive në distancë. <i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Laboratorë të tjerë mësimor janë 9. Në sallat e pajisura me mjete audio vizive u mundësohet studentëve paraqitja e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës, u demonstron si bëhen teste të ndryshme, etj. <i>GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të laboratorëve të fizioterapisë me materialet didaktike të nevojshme.</i> <i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UET ka aktualisht në përdorim 7 laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. <i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Me infrastrukturen që zotëron institucioni garanton mjediset të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarive mësimore. Ndërkohë nëbashkëpunim me institucione të tjera, në funksion të studentëve, janë vënëmjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Marrveshje janë nënshkruar me qendra spitalore dhe klinika të ndryshme për të kryer praktikat profesionale. <i>(Ref.Dok.Nr.32 Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.34.1-34.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjediset mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjediset të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Universiteti European ka bibliotekë të pajisur me literaturë të gjerë për studentët. Biblioteka e institucionit, e vendosur në godinën A dhe me një sipërfaqe prej 35 m ² është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e programit MSH Fizioterapi. <i>(Vizita në institucion)</i>

<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodik, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Literatura e bibliotekës gjendet kryesisht në gjuhën angleze. <i>Biblioteka zoteron shumë pak tituj shqip në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, për vetë specifikën e programit.</i></p> <p>Akresi i literaturës së programit nga studentët, garantohej nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Literaturës fizike në bibliotekë. Ka procedura për pasurimin e Bibliotekës vit pas viti. Për këtë stafi akademik parashtron kërkesën për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësimit të formatit përkatës; 2. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia; 3. Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj; 4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS. <p><i>(Ref.Dok.Nr.45 Inventari i teksteve);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.45.1 Mbi funksionimin e Bibliotekës);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.45.2E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.45.3 Shembuj procedure blerje literature);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.42;Nr.42.1 Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës_Infrastruktura)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, Wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela Nr. 17: Të dhëna për platformat on-line/strukturat IT/Biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Në bibliotekë janë të instaluar kompjutera që mundësojnë kërkim të shpejtë dhe navigim të literaturës online duke mundësuar shfrytëzimin pa kufizime nga ana e studentëve.</p> <p><i>(Vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar përmirësimin e infrastrukturës së vet për shtimin e zërave të bibliotekës me botime të fushës së mjekësisë. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara edhe në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit.</p> <p><i>E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka zhvillon aktivitetin e vet gjatë orarit zyrtar të institucionit. Në periudhë provimesh apo aktiviteteve të tjera, ajo punon edhe me orar të zgjatur. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-e Premte 9:00-20:00 dhe e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. <i>(Vizita në bibliotekë)</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti European disponon sisteme të menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Platformat e vëna në dispozicion Microsoft Teams, UET – LMS, Google meet etj. Institucioni menaxhon informacionin për studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. <i>(Ref.Dok.Nr.46 Manual i përdoruesit të sistemit UMIS)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni disponon sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit institucional. Sistemi mundëson menaxhimin e aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ruajtja e të dhënave nga veprimtaritë dhe analiza e tyre mundësohen nëpërmjet sistemit që UET disponon. Studentët mund të aksesojnë informacionin si leksionet apo materialet didaktike nëpërmjet sistemit online. <i>(Ref.Dok.Nr.46 Manual i përdorimit të sistemit UMIS)</i> <i>(Vizita në IAL)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka vënë në përdorim platformën UET LMS (Learning Management System), duke filluar nga viti akademik 2016-2017. UET LMS është standardi më bashkëkohor i përdorur nga gjithë universitetet prestigjioze në botë në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht të gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. <i>(Ref.Dok.Nr.46 Manual i përdorimit të sistemit UMIS); (Vizita në IAL)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve si p.sh MS.Terams, Moodle, LMS.

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

52

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<i>(Ref.Dok.Nr.46 Manual i përdorimit të sistemit UMIS)</i>		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	UET mundëson monitorim të shumicës së veprimtarive që zhvillon institucioni veçanërisht aspektet mësimore. Nëpërmjet platformës së mësimit online, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit mësimor dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale pjesmarrjen, frekuentimin dhe zhvillimin e veprimtarive akademike. <i>(Vizita në IAL)</i>		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	UET është mjaft aktiv në web dhe në rrjetet sociale. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Faqja zyrtare e internetit gjenden në gjuhën shqipe dhe atë angleze, po ashtu dhe informacionet e sipërpërmendura për stafin akademik, aktivitetet dhe programin gjenden në web në gjuhën angleze. Stafi https://uet.edu.al/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike/ https://uet.edu.al/en/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike/ Programi i studimit https://uet.edu.al/master-shkencor/ https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/MSc-Physiotherapy.pdf Aktivitetet https://uet.edu.al/te-rejat/ Revista shkencore “Medicus” https://uet.edu.al/medicus/		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Njësitë përbërëse të UET dhe departamenteve të tij, hartojnë projekt buxhetin në muajin tetor të çdo viti dhe përzbatimin e këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Për programin e studimit, plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit, është e limituar. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje, zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.

	<p><i>(Ref.Dok.Nr.50.1-50.3 Pasqyrat financiare me shënime);</i> <i>(Ref.Dok.Nr. 50.4-50.6 Raportet e auditimit)</i> <i>(Vizita në IAL)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimduhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit.</p> <p><i>(ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 18.1: Të dhëna mbi koston për student; Tabela 18.2: Të ardhura dhe financime të ndryshme)</i></p> <p><i>(Vizita në IAL)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Programi është i ri megjithatë në funksion të analizës vjetore, institucioni kryhen vlerësimin e tij dhe të programeve që ofron. Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ka numër të vogël studentësh gjatë 3 viteve të fundit akademik për pasojë të ardhurat financiare kanë qenë minimale. Kjo ka dalë edhe nga raportet e auditit financiar. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p> <p><i>(Vizita në IAL); (Ref.Dok.Nr.50.1-50.3 Pasqyrat financiare me shënime)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Programi i ofruar është i ri por Universiteti përpiqet për tërheqjen e studentëve në këtë program studimi. Kjo bazuar në takimet me drejtues dhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi. UET ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p> <p><i>(Vizita në IAL)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka</p>	<p>Universiteti European ka një histori relativisht të gjatë në arsimin e lartë në vend. Ai ka dëshmuar se garanton qëndrueshmërinë financiare të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>

kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<i>Për shkak se aktualisht institucioni mbështetet në tarifën e studentëve për realizimin e programeve të studimit, rekomandojmë që në të ardhmen të diversifikohen mundësitë e sigurimit të të ardhurave, përmes aplikimit në projekte të sigurimit të granteve fitimprurëse që mbështesin veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminë programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor, elementët e mësimdhënies IAL, hartohet një shpërndarje të aktiviteteve akademike dhe përcaktohen kushtet dhe mundësitë për një përfundim me sukses të këtij programi nga ana e studentëve. Rregullorja e programit mësimor parashikon procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga statusi i studentit, si dhe kushtet e diplomimit. Politikat e programit janë të barabarta për të gjithë studentët. <i>(Ref. Nr.7 Rregullore e programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Modalitet e pranimit në të gjitha programet e studimit përcaktohen me vendim senati në mbështetje të kriterëve kombëtare të përcaktuara në LAL dhe propozimeve të njësisë bazë. Kriteret shpallen dhe u bëhen të ditur të gjithë aplikantëve gjatë periudhës së informimit. Kushtet dhe procedura e transferimit të krediteve gjithashtu janë të kuptueshme dhe u bëhen të ditur aplikantëve nga koordinatori i programit. <i>Ref.Dok.Nr.27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në këtë program studimi pranohen student të cilët kanë përfunduar me sukses studimet Bachelor në fusha të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit në fjalë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, dhe janë të përcaktuara dhe të zbatueshme sipas Nenit 35 të Rregullores së UET mbi 'transferimin dhe mobilitetin e studentëve' që përcakton të drejtën dhe procedurat mbi transferimet dhe kriteret e duhura. Ato i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve sikurse janë të aksesueshme dhe në intranetin e UET. <i>(Në intranetin e UET ndodhet folderi Dokumenta_UET në të cilin gjenden aktet rregullatore)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Politikat e pranimit të studentëve kanë ardhur duke u konsoliduar. Megjithatë, vlen të theksojmë se në UET përpara fillimit të vitit akademik organizon takime pune për të vlerësuar çfarë ka nevojë të përmirësohet për vitin në vijim dhe ndryshimet e nevojshme në dokumentacionin rregullues duke ju referuar rregullores për Masterin Shkencor dhe Ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nën-ligjore. Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UET, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve me ta, sikurse dhe reflektohen në dokumentet respektive të listuara në kriterin 1 dhe 3 më lart.<i>(Takimet ne IAL)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me</p>	<p>Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit, stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep informacionin e nevojshëm për pranimin e studentëve, dhe</p>

kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	shpërndahet përmes rrugëve të ndryshme të komunikimit. Informimi kryhet vazhdimisht përmes Zyra të Kujdesit ndaj Studentit, gjimnaz-tureve të organizuara gjatë vitit, fushatave publicitare të organizuara nga zyra e PR, informimeve dhe takimeve të hapura në universitet me gjimnazistët e ftuar nga gjimnaze të ndryshme, përmes broshurës së UET, si në formatin hard-copy, po ashtu edhe online. Gjithashtu në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit. Kjo është një traditë që UET e zhvillon çdo vit për të ndihmuar studentët e rinj që të njihen më shumë me programet, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. <i>(Ref.Dok.Nr.51 Komunikimi i integruar i marketingut);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit njih studentën me rregulloren e programit në lidhje me kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijës, pikëzimin e elementëve të shumfishtë, konvertimin e pikëve në notë si kushtet për të kaluar nga një vit në tjetrin. Në bazë të kushteve të njohjes dhe transferimit të krediteve studentëve u bëhet e ditur se Procedurës së ekuivalentimit i nënshtrohen studentët që kanë mbaruar apo kryer pjesërisht programe universitare me orientim mjekësor me module të ekuivalentuara nga komisioni përkates i ngritur nga UET. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati në studimet e kryera prej tij, bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit të studimit_MSH Fizioterapi)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Pikëzimi i elementëve të vecantë kryhet në varësi të ngarkesës dhe karakteristikave të modulit. Ky pikëzim shprehet në syllabusin e modulit dhe u bëhet i ditur studentëve në ditën e parë të mësimet. Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, UET-i informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve ose studimeve të pjesshme. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentin, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet. Institucioni sipas Nenit 35 të Rregullores së UET ka të përcaktuar procedurat dhe kriteret mbi transferimet dhe mobilitetin e studentëve. UET pranon transferime të studentëve nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. <i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu VII)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Mbështetur në Kreun V të Rregullores së UET dhe në Nenin 23 dhe 24 mbi Mënyrën e Kontrollit dhe Sistemin e Vlerësimit, Institucioni ka të përcaktuara

procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programet e studimit. Në fillim të vitit akademik, studentit përmes koordinatores së departamentit i vihet në dispozicion silabusi për çdo lëndë të programit të studimit. Pjesë e silabusit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. <i>(Ref.Dok.Nr.7 Rregullore e programit të studimit_MSH Fizioterapi); (Ref.Dok.Nr.19 Silabuset e lëndëve).</i>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Koordinatori i programit informon studentët për procedurat e diplomimit në fillim të vitit akademik në mënyrë që ata të përgatiten. Po ashtu koordinatori i departamenti koordinon punën shkencore të studentëve në përgatitjen e temave të Diplomës.Dokumenti për punimin e diplomës, pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës të Departamentit, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen. <i>(Ref.Dok.Nr.10 Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Studentët dhe gjithë të interesuarit kanë mundësi të marrin informacion për programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare të UET, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjegjësit të Departamentit, vecanërisht në muajin shtator gjatë periudhës së informimit. Gjithashtu UET organizon grupe pedagogësh të cilët vizitojnë gjimnaze të ndryshme të vendit për ti informuar studentët potencialë mbi programet e studimit që ofron UET. Edhe për faktin që regjistrimi kryhet në disa raunde sipas udhëzimeve të MASR, gjatë gjithë kohës së regjistrimeve dhe periudhat midis rraundeve konsiderohen ditë të hapura për informacion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, stafi akademik si dhe rregullorja e programit të studimit,u jep studentëve informacionin e detajuar për organizimin e procesit mësimor, kalendarin akademik ku përfshihen datat e fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor, periudhat e teorisë dhe praktikës, sesionet e provimeve dhe mbrojtja e diplomës. Mbështetur edhe në nenin 37 mbi Tutoriatin dhe këshillimin akademik, Këshillimi akademik është një shërbim që iu ofrohet studentëve të ciklit të dytë dhe synon t'i ndihmojë ata të identifikojnë dhe të arrijnë qëllimet e tyre akademike. <i>(Ref.27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik)</i>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përveçse mënyrave të informimit përmendur mësipër, studentët informohen për planin mësimor të programit edhe në faqen web të UET, apo edhe në platformën LMS (Learning Management System).</p> <p>Veç të tjerash, vlen të përmendet fakti se që nga momenti i shpalljes së pandemisë dhe fillimit të mësimin online është detyrim akademik që çdo informacion në lidhje me modulet të publikohet për studentët në klasën e planifikuar në platformën LMS.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon studentët për mundësi punësimi nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës e cila ofron këshillim për zhvillimin e një karriere të suksesshme për të gjithë studentët si dhe Bordeve të Tregut të Punës. Qëllimi kryesor i Zyrës së Këshillimit të Karrierës është që t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve që vazhdojnë dhe që kanë përfunduar studimet në UET, për të arritur potencialin e tyre maksimal dhe për tu mirëorientuar në tregun e punës.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës përpiqet të mbajë kontakte me studentët e diplomuar por vlen të theksohet se të gjithë brezi i parë i studentëve të diplomuar kanë qenë dhe janë të punësuar në institucione të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Ndërsa Bordet e Tregut të Punës janë një mundësi tjetër lidhëse e UET me tregun e punës.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.12.1 Bordi i Tregut të Punës)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen dhe përditësohen vazhdimisht nga koordinatoresha e departamentit, për zhvillimin e programit si oraret mësimore, auditoret, praktikat dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm që lidhet me procesin mësimor. Platforma LMS e vënë në dispozicion të procesit akademik është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik në funksion të realizimit të mësimdhënies online në kushtet e krijuara nga COVID-19. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve (referuar Neni 21, Orari i mësimin, Rregullore UET). Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 21)</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët e UET informohen mbi ecurinë e programit të studimit nëpërmjet platformës UMIS, që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash, ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin informacion që lidhet me performancën e tyre akademike.</p> <p><i>(Ref.46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS)</i></p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit bën të mundur pasqyrimin dhe administrimin e informacionit, dokumentacionit duke e vënë atë në dispozicion të studentit, i cili e akseson në çdo kohë. Të gjitha dokumentat ndodhen dhe mund të shkarkohen sa herë është e nevojshme, në sistemin e menaxhimit UMS në formën online. Studenti merr informacion lidhur me</p>

	dhe pikët nëpërmjet këtij sistemi. Nga ana tjetër, aktiviteti mësimor i studentëve, mund të aksesohet nga zyrat e IT dhe t'i vihen në dispozicion pedagogut e studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mban informacion në lidhje me studentët e regjistruar dhe të diplomuar në këtë program studimi. Në vitin 2020-2021, janë diplomuar 3 studentët e parë nga ky program studimi, ku të 3-të rezultojnë të punësuar në përputhje me diplomën. <i>(Ref.Dok.Nr.29 Monitorimi i ecurise se studenteve, diplomimit dhe punesimit te tyre)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Universiteti ruan në regjistrat fizikë dhe elektronikë gjithë dokumentacionin vjetor për regjistrimin, ngrirjen e studimeve dhe largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Ky informacion është i ruajtur në kohë reale në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore si dhe në dosjen e secilit student në sekretarinë mësimore. Konkretisht në vitin akademik 2019-2020, ka patur 3 studentë të regjistruar, në vitin akademik 2020-2021, 9-studentë të regjistruar dhe në vitin akademik 2021-2022, 6 studentë. <i>(Takimi në Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore disponon dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. Ky informacion është në formë fizike me nënshkrimet e personave sipas karakteristikës së dokumentit dhe i ruajtur elektronikisht në sistemin e brendshëm UMIS, ku secili person i autorizuar ka akses të kufizuar në bazë të pozicionit të punës. <i>(Ref.Dok.Nr.9 Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përveç dokumentacionit fizik të nënshkruar (procesverbalet, regjistrat) rezultatet e studentëve disponohen edhe në formë elektronike në platformën UMIS. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave kanë të drejtë të hedhin dhe të modifikojnë informacione personale të autorizuar në varësi të detyrës që kanë.Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS, administrohet nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMS.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim.

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<i>(Ref.Dok.Nr.8 Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të prishme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në RVB dhe Satutin e institucionit, studentët përfaqësohen në organe dhe komisione të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese. Ndër strukturat kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët. (RVB); (Ref.2. Statuti UET)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Zëri dhe përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në komisione organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, GVB, Senati Akademik etj. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit MSH Fizioterapi , ishte pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti. (RVB);(Takim me zyrën e cilesise);
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në këtë program studimi, institucioni kryesisht nëpërmjet pyetësorit të studentëve i cili realizohet dy herë në vit, mer mendimin e tyre mbi programin e studimit. Aktualisht në këtë program studimi studentët ndjekin në total të dy viteve 18 lëndë. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimeve përkatëse të MAS-it dhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti European i Tiranës pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në këtë dokument. Studenti duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 30% të ECTS-ve teorike, si dhediplomën dhe praktikën profesionale. Në çdo rast student i duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 25% të ECTS-ve teorike, si dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

	<p>diplomën dhe praktikën profesionale. Studenti ka të drejtë të aplikojë vetëm një herë për transferim lëndësh dhe kreditesh. <i>(Ref.Dok.Nr.5 Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu VII, Neni 35);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.2 Statuti UET, neni 37);</i> <i>(Ref.Dok.Nr.28 Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes Pyetësorit me studentët. Pyetësi organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Ndër elementët që vlerësohet është edhe silabusi i lëndës. Gjithashtu edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, marrja e opinionëve nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, marrin opinionin e studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe pedagogëve me të cilët studentët kanë kryer mësimin. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatorë dhe ato respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Personeli akademik ka marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, me prezantim oral apo postera. UET është angazhuar në programin kërkimor “Shqipëria Inovative 2015-2020”, gjithashtu në kuadër të programeve 250+ dhe 500+, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo kompani te ndryshme, me synimin që të realizojë studime të përbashkëta kërkimore, programe shkëmbimi të studentëve, shkëmbimin e të dhënave kërkimore akademike dhe materialeve teknike, organizimin e veprimtarive të përbashkëta akademike dhe shkencore si konferenca, seminare, simpoziume, etj.Stafi akademik motivon studentët të botojnë në revisten Medicus që ka institucioni.(https://uet.edu.al/medicus/)</p>

	<p>Ky program studimi si një program në fushën e shkencave mjekësore, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në rrugën e kërkimit shkencor duke u përpjekur të përfshihet në studime inovative apo të hapë rrugë drejt patentave.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.43.1 Të dhëna mbi publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit 2018-2021)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Sipas Planit strategjik 2021-2025, "Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore "pika 3, UET synon nxitjen e sa më shumë bashkëpunimeve e kooperime dypalëshe apo shumëpalëshe të shoqatave dhe grupeve të studentëve me universitete analoge në Shqipëri, rajon, vendet e BE dhe më gjerë. Në Planit strategjik 2015-2020, "Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar", pika 3, thuhet se UET synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët. UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.</p> <p><i>(Referim Shtojces mbi institucionet e praktikës për Masterin Profesional dhe Shkencor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime dhe punime shkencore. Tashme qe departamenti ka edhe revistën e tij shkencore me ISBN, studentët do kenë mundësi të gjëra të publikojnë gjerësisht. Edhe pse Departamenti është një njësi e re së bashku me programin e studimit MSH Fizioterapi, me profil "Teknika Rehabilitimi", në UET, treguesit e përfshirjes së studentëve në aktivitete shkencore jepen në Tabelën 22 (Aneks Tabelat). Për më tepër, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka formuluar politikat dhe ofron mbështetje ndaj studentëve, dhe në të ardhmen ka potencial për rezultate akoma më pozitive.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.02 Dokumentit Tabelat përmbledhëse për Ankes RVB / Tabela 22)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit, Prioritetet në kërkimin shkencor)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas Planit strategjik 2020-2025, pika 1, prioritet të madh ka kërkimi shkencor ku UET duhet të shndërrohet në një qëndër të rëndësishme kombëtare dhe rajonale në zhvillimin dhe cilësinë e kërkimit shkencor, në një institucion që kërkimin shkencor e ka prioritar në aktivitetin e përditshëm të saj, që shmang praktikat e gabuara të një "kërkimi shkencor formal apo fasadë" duke u përqëndruar në kërkimet shkencore teorike dhe aplikative me prioritet "studimet shqiptare e rajonale" në funksion të zhvillimit ekonomik, social e kulturor. <i>(Ref.Dok.Nr.3.5 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Studentet motivohen nga personeli administrativ dhe akademik për të marrë pjesë aktive në studime inovative, të cilat mund të kenë një pikësynim në ndihmë të vetë institucionit apo të aplikohen në jetën e përditshme në të ardhmen. <i>(Ref.Dok.Nr.3.5 Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025)</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve</p>	<p>Ne kuadër të realizimit të diplomës, çdo student ka në dispozicion një pedagog udhëheqës, i cili e orienton lidhur me mënyrën e punimit, kryerjen e analizave, matjeve, përmbledhjes së literaturës së konsultuar dhe kryerjes së studimit,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

63

studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	pas kësaj në momentin e përpunimit të rezultateve, atij i qëndron pranë edhe pedagogu i Metodologjisë së Kërkimit Shkencor, por edhe zyra e IT.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni në funksion të strategjisë së ndërkombëtarizimit, ndjek dhe realizon politika bashkëpunimi me organizmat shkencorë, duke mundësuar mobilitetin e studentëve dhe personelit. Institucioni në kuadër të marrëveshjeve të shumta në numër, rreth 95 marrëveshje, mundëson praktika të mobilitetit për studentët. <i>(Ref.Dok.Nr.34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese: Marrëveshjet e bashkëpunimit UET)</i>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Në takimin me studentët u njoftuam edhe me raste konkrete mobiliteti, ku u informuam në mënyrë më të detajuar për eksperiencën dhe vlerën e fituar në semestrin jashtë. Programi i studimit në vija të përgjithshme ofron mundësi për vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. <i>(Takimi me studentët)</i>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Nga CV-të e dorëzuara të personelit akademik dhe bisedave me ta konstatohet që ka angazhim të studiuesve të rinj në projekte kërkimore të institucionit. Institucioni synon ndërkombëtarizimin e vet dhe mobiliteti i studenteve të këtij programi përmes programit Erasmus + është një përpjekje pozitive. Ky kriter përbushet, Plani strategjik 2020-2025, pika 4. Studentët përfshihen në projekte të ndryshme kërkimore, më shumë kemi patur raste të projekteve kërkimore vëndase e më pak të huaj, por sapo universiteti arrin një marreveshje apo realizon pjesëmarrje në një projekt, e vë atë në dispozicion të studentit. <i>(Plani strategjik 2021-2025, pika 4)</i>
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. Ky kriter përbushet, Plani strategjik 2021-2025, pika 4. Kërkuesit shkencorë të huaj janë gjithashtu të mirëpritur në universitet, duke u vënë atyre në dispozicion të gjitha të dhënat që ata mund të aksesojnë, por nuk kanë qënë të shpeshta mundësitë për ta bërë këtë shkëmbim, duke qënë se programi është licencuar në vitin 2018. <i>(Ref.Plani strategjik 2021-2025, pika 4.)</i>
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Ky kriter përbushet, Plani strategjik 2020-2025, pika 4. Shkëmbimet ndërkombëtare studentore janë një ndër politikat e preferuara të institucionit, i cili e ndërmerret këtë mobilitet sa herë shfaqet mundësia për aktivitete ndërkombëtare. <i>(Ref.Plani strategjik 2021-2025, pika 4.)</i>

<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Njësia kryesore/bazë është Departamenti (Neni 5, Rregullore e Universitetit European të Tiranës). Kreu II Struktura Organizative e Rregullore e Universitetit European të Tiranës përcakton njësitë përbërëse të strukturës dhe se si ato janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të koordinimit të aktiviteteve në funksion të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Një ndër njësitë kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshin stafin akademik është Zyra e Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim, misioni i së cilës është të ndihmojë në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të UET-it.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e akreditimit, UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për FSHMT. Gjithashtu, lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional.</p> <p>Përmes programeve Erasmus +, Universiteti mundëson lëvizshmërinë studentëve dhe stafit akademik, në Universitete të tjera jashtë vendit, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre.</p> <p>Në programin e studimit MSH Fizioterapi, nuk ka patur raste të mobilitetit të studentëve, ndërsa për sa i përket mobilitetit të stafit akademik ka patur raste të vizitave për mësimdhënie në universitetin partner Universitetin Szczecin, në Poloni.</p> <p><i>(Ref.Dok. 35 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.)</i> <i>(Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.8</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Dokument Nr. 12 (<i>Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>), përcakton rregullat e funksionimit të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, dhe kjo zyrë duket të jetë zyrë kryesore që e plotëson këtë kriter. Po ashtu secili departamenti sipas raportit të vetëvlerësimit ka këshillim akademik dhe metodologjik, e cila është përcaktuar dhe përmendur në <i>dokumentin Ref. Nr. 27.2.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studenti në UET mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET-it.</p> <p>Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht 'fokus grupe' për të marrë</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

65



procesin mësimor dhe programin e studimit.	informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen, por edhe nevojave dhe ndihmës ndaj studentëve që kanë mbetur prapa me studimet, duke u ofruar mbështetjen e nevojshme.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik, por janë plotësues të njëra-tjetrës. <i>(Ref.12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	GVJ konstatoi nga takimet me përfaqësuesit e zyrës dhe dokumentacioni i shqyrtuar, se institucioni ka të dhëna për shkallën e punësimit që janë të dokumentuar. Studentët kontaktohen në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet pyetësorëve dhe takimeve mujore me Departamentin, kurse Zyra e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve dhe i vë ato në dispozicion të organeve dhe autoriteteve drejtuese në mënyrë periodike. <i>(Ref.Dok.Nr. 12 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit),</i> <i>(Ref.Dok.Nr. 29 Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Për të siguruar instrumentet e duhura të sigurimit të cilësisë, UET funksionon në përputhje me normat ligjore në fuqi, sic janë Statuti i UET, Rregullorja e UET dhe aktet rregullatore.</p> <p>Në UET sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili është i përbërë nga 12 anëtare, dy prej të cilëve studentë dhe një ekspert i jashtëm. Ky komision është ngritur dhe funksionon në përputhje me rregulloren specifike hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve statutore të UET.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në kuadër të ngritjes se grupeve vjetore të punës për SBC sigurohen të gjitha procedurat e caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve. Institucioni përveç KSBC ka në strukturën e tij dhe një tjetër zyrë e cila jep kontributin e saj në sigurimin e cilësisë, siç është Zyra e Standardeve dhe Cilësisë.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30.4 Urdhër mbi përbërjen e KSBC)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Rëndësia e implementimit të standardeve të cilësisë u shpjegohet në vazhdimësi stafit dhe studentëve të rinj dhe atyre që marin pjesë në programet e ndryshme ekstrakurikulare.</p> <p>UET në kuadër të planit të përgjithshëm strategjik rëndësi dhe vend të veçantë i kushton cilësisë së procesit mësimor si edhe të shërbimeve mbështetëse për realizimin e këtij procesi. Për këtë arsye zhvillohen monitorime periodike nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përmes pyetësorëve online të vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, zhvillimit të fokus grupeve, kontrollit të syllabuseve, kontrollit të provimeve, por edhe vetë Departamenti përmes vizitave në orën e mësim, shqyrtimit të syllabuseve, takimeve të hapura me studentët, takimeve me Bordin e Punës.</p> <p>Po ashtu, në kuadër të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë, i janë nështruar procesit të akreditimit në mënyrë periodike dhe programet e studimit. Në këtë drejtim, në UET është zbatuar procesi i kontrollit të ligjshmërisë i ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET plotësonte standardet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e aktivitetit akademik; janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përmbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukurore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p> <p><i>(Vizita në institucion)</i></p>

	<p><i>(RVB)</i> <i>(Ref.Dok.30.1 Plani veprimi KSBC)</i> <i>(Referuar të dhënave për akreditimin e programeve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, që gjenden në fq.2 të Dok.Nr.26 Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga departamenti Tabela 3 Aneks)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike, dhe zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar (Plani i veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse.</p> <p>Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njëjsteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njëjsteve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.30.1 Plani veprimit KSBC)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjsteve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Njësia ofruese e programit të studimit (departamenti) dhe KSBC monitorojnë ecurinë e programit të studimit si edhe vlerësojnë syllabuset e lëndëve konform planit mësimor. Gjithashtu rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe koordinatorët e programeve të studimit.</p> <p>Bordet e Tregut të Punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këto rekomandime bëhen bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshatjes sa më mire me këto kërkesa.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.36 Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit)</i> <i>(Ref.Dok.Nr 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. Institucioni ka një hierarki funksionimi dhe mbikëqyrje që mban nën kontroll të vazhdueshëm zbatimin me rigorozitet të rregulloreve. Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe Koordinatori i programit të studimit si dhe KSBC, koordinojnë dhe mbikëqyrin vazhdimisht zbatimin e programit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe</p>	<p>KSBC bashkëpunon me aktorët kyç që marrin pjesë në mësimdhënie dhe komunikon me aktorë jashtë njësisë me rëndësi në funksionimin e institucionit. Problematikat e hasura i transmetohen nga njësia e SBC Rektorit i cili ja</p>

68

<p>vlërësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>komunikon senatit i cili merr masat e duhura për përmirësim. Vendimet mbi hapat që do të merren për përmirësim të problematikave diskutohen në senat rast pas rasti.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UET nëpërmjet KSBC, çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili përmban edhe plan masa për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjësesikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.8 Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Gjetjet e vlerësimit vjetor, që janë pjesë e raportit vjetor të KSBC, i vihen në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR.</p> <p>UET ndër të tjera ofron edhe programe studimi të profilizuara në fushën e shkencave mjekësore. Formimi i profesionistëve në këtë fushë është pjesë e misionit dhe strategjisë së universitetit dhe përputhshmëria midis tyre vlerësohet periodikisht.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, UET për garantimin e mbarëvajtjes së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi me pikë; • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; • Testet e standardizuara; • Dëgjimet në Auditor; • Testimet paraprake dhe ato përfudimtare etj.

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore të cilat janë inkorporuar në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe në Programet e veçanta të studimit. Të gjitha këto janë pjesë e dokumentacionit mësimor (proçes verbale) të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore. Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eprori (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format ligjore, përfshi këtu testimet, Seminaret, Detyra Kursi, Projektet, Prezantime etj. Të gjithë studentët gjatë kryerjes së Praktikave të tyre mbikqyren nga përgjegjësit e caktuar.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30.8 G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program</p>	<p>Metodat e tërthorta: Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto proçese. Sistemi i koordinatorëve të programeve, mundëson në mënyrë permanente intervistimin e studentëve për të gjitha aspektet e proçesit arsimor. Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik raporte mbi problematikën e hasura gjatë proçesit akademik, gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave në lidhje me mirëfunksionimin dhe angazhimin e studentëve në shërbimet spitalore.</p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.30.8 G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu)</i> <i>(Ref.Dok.Nr.40G.III.4.2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proçeset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e</p>	<p>Në përbërje të KSBC ka nga një anëtar nga çdo fakultet, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve. Megjithatë në funksion të proçesit akademik ka një angazhim të shumëfishtë që përfshin personelin</p>




<p>brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>administrativ, koordinatori e programit, sekretarinë mësimore si dhe drejtuesit e njësisë bazë që janë në kontakte të vazhdueshme me studentët. Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti Erasmus+ QAINAL. Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me fokus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1. <i>(Ref.Dok.Nr.30.9 Fisha e projektit ENCHASE); (Ref.Dok.Nr.30.10 Fisha e projektit QAINAL)(Ref.Dok.Nr.30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022) (Ref.Dok.Nr.28.5 Të dhëna stafin dhe student të angazhuar në projekte)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjitha strukturat dhe anëtarët e përfshirë në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, i kanë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në aktet rregullatore të UET. Strukturat e ngarkuara veçanërisht në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë, departamenti, koordinatori i programit, stafi akademik, sekretaria mësimore, zyra e këshillimit të karrierës, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me KSBC. Komunikimi me studentët realizohet nëpërmjet pyetësorëve, nga ku raportohet problematika më e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Ref.Dok.Nr.2 Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KSBC bashkëpunon me departamentet si njësi bazë në mënyrë që ato të realizojë rritjen dhe ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies konform rregullores së njësisë. Ky komision njësi ka në përbërje grupin përkatës, i cili vlerëson periodikisht cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore-kërkimore për personelin akademik dhe studentët, si edhe aktivitetin administrativ të institucionit. Ky komision është i pavaruar dhe siguron ushtrimin e kompetencave të strukturave përbërse të institucionit në përputhje me kufijtë e autonomisë që ato gëzojnë sipas statutit. Detyrat dhe roli i anëtarëve të KSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit të tij. <i>(Ref.Dok.Nr.8 Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ky kriter përmbushet duke qënë se në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, që kryen proceset ciklike të vlerësimit, meren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompetencat profesionale; • Paanshmëria; • Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin; • Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; • Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET; Etj.

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

71

	<i>(Ref.Dok.Nr.8 Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.7)</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ky kriter përmbushet nëpërmjet angazhimit të ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, nëpërmjet takimeve me Bordin e Tregut të Punës. Edhe pjesëmarrjet që UET ka patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë tregues i angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë. <i>(Ref.Dok.Nr.30 Të dhëna për anëtarët e NJSBC); (Ref.Dok.Nr.30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC); (Ref.Dok.Nr.12.1 Bordi i Tregut të Punës); Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9); Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 30.10)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika që ndiqet për përmirësimin e cilësisë në bazë të kontrolleve periodike është trajtimi dhe zgjidhja e problematikave që raportohet apo zbulohet nga auditimet e strukturave të institucionit apo nga pyetësorët e studentëve, vetë pedagogët apo hallkat më të larta drejtuese të institucionit. KSBC-ja në punën e saj vepron sipas nje plani veprimi të miratuar. <i>(Ref.Dok.Nr.30.1 Plani veprimit KSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	KSBC çdo fund viti akademik diskuton raportet vjetore me aktorët e përfshirë në to, por për shkak të të dhënave të cilat insitucioni i konsideron sensitive, nuk i publikon ato. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Për problematika e evidentuara diskutohen mundësitë e përmirësimin në senat dhe në mënyrë individuale komunikohet për gjetjet problematike.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i KSBC së bashku me plan masat e sugjeruara, kalohet në senatin akademik i cili nxjerr në formën e vendimeve masat që duhet të merren për përmirësim. Senati Akademik ndërmerr masat që vlerëson në kuadër të përmirësimin të cilësisë dhe ka autoritet për të monitoruar implementimin e tyre.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UET përmes kontrollit të kryqëzuar nëpërmjet disa hallkave si, përgjegjësit e grup-lëndëve, KSBC, Zyrës së Kurrikulave dhe Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, siguron kontrollin dhe ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e stafit akademik për sigurimin e cilësisë në programin e studimit.

	<p><i>(Ref.Dok.Nr.36 Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit të studimit)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.13 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave)</i></p> <p><i>(Ref.Dok.Nr.8 Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë, por edhe në mënyrë të tërthortë duke qënë se veprimtaria i bëhet e ditur si stafit akademik, ashtu edhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahe nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloreve; • Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senatin Akademik); • Këshillit të studentëve; • Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik). 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi” me profil “Teknika Rehabilitimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik.
2. Mbështetja dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit akademik dhe njohja e tyre me metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, publikimi i revistës shkencore të Fakultetit: Medicus (<https://uet.edu.al/medicus/>).
3. Marrëveshjet me institucionet shëndetësore, qendra spitalore si brenda dhe jashtë vendit, ofrojnë mundësinë e trajnimit dhe kualifikimit të mëtejshëm për studentët dhe i bën ata të jenë të gatshëm për tregun e punës menjëherë pas diplomimit.
4. Aplikimi i bursave të ekselencës nëpërmjet aktiviteteve të përvitshme si “tour”-eve në gjimnaze, Shkolla Dimërore, Klubet Studentore, trajnimeve profesionale si dhe mbështetja e tyre me bursë studimi që nxisin ruajtjen e rezultateve të larta akademike, janë një investim i UET që shkon drejtpërdrejt në shërbim të rritjes së cilësisë së studentëve që pranohen në program, e si rrjedhojë edhe të ofrimit në të ardhmen e një stafi të kualifikuar në institucionet ku ata do të punësohen.

Pika të dobta:


1. Stafi pedagogjik i angazhuar kryesisht për lëndët profesionale pa grada dhe tituj sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Shqiptar.
2. Pavarësisht disponibilitetit të literaturës së nevojshme për programin e studimit të Fizioterapisë në formatin elektronik, biblioteka nuk është e pajisur mjaftueshëm me tekste për fushën e fizioterapisë në hard copy në dispozicion të studentëve, edhe pse u konstatuan në raftet e bibliotekës mjaftueshëm tekste për Mjekësinë e përgjithshme dhe jo për fizioterapinë.

Rekomandime:

1. Rekomandohet që institucioni të krijojë mundësinë e stimulimit dhe pjesëmarrjes së stafit të brendshëm të programit, të profilit fizioterapeutik, në studimet e ciklit të tretë;
2. Të mundësohet nga institucioni përkthimi/ përshtatja e teksteve pjesë e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në gjuhën shqipe.



3. Krahas mjeteve didaktike prezente në laboratorët mësimor të dedikuara për programet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, rekomandohet të shtohet baza materiale didaktike në funksion të programit.
4. Sugjerojmë të shikohet mundësia e rritjes së numrit të studentëve Master Shkencor, me anë të reklamimit të vlerave të Universitetit në ditët e hapura në takimet me maturanët e gjimnazeve jo vetëm të Tiranës por edhe të rretheve, nëpërmjet promovimit të Universitetit në media të ndryshme ose publikimeve të ndryshme.
5. Rekomandojmë që institucioni të promovojë dhe të mundësojë diversifikimin e burimeve të financimit për programin e studimit i cili aktualisht mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve.




Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in “Physiotherapy” profile “Rehabilitation Techniques” of the Institution of Higher Education “European University of Tirana”

Strengths and Affirmations:

1. Teaching based on contemporary methods and e-learning system at the service of students and academic staff.
2. Continuous support and training of academic staff and their familiarization with the most contemporary methods of teaching and scientific research, publication of the scientific journal of the Faculty: Medicus (<https://uet.edu.al/medicus/>).
3. Agreements with health institutions, hospital centers both inside and outside the country, offer the possibility of further training and qualification for students and makes them ready for the labor market immediately after graduation.
4. The application of excellence scholarships through annual activities such as “tours” in gymnasiums, Winter School, Student Clubs, professional trainings as well as their support with scholarships that encourage the maintenance of high academic results, are an investment of UET which goes directly to the service of increasing the quality of students who are accepted into the program, and therefore also the provision in the future of a qualified staff in the institutions where they will be employed.


Weak points:

1. Pedagogical staff mainly engaged in professional subjects without degrees and titles according to the Albanian Higher Education Law.
2. Despite the availability of the necessary literature for the Physiotherapy study program in electronic format, the library is not sufficiently equipped with texts for the field of physiotherapy in hard copy available to students, even though enough texts for General Medicine were found on the library shelves, but not for physiotherapy.



Recommendations

1. It is recommended that the institution creates the possibility of stimulation and participation of the program's internal staff, of the physiotherapeutic profile, in the studies of the third cycle.
2. The institution should enable the translation/adaptation of the texts that are part of the mandatory and auxiliary literature in the Albanian language.
3. In addition to the didactic tools available in the teaching laboratories of dedicated to the programs of the Faculty of Medical and Technical Sciences, it is recommended to add didactic materials in function of the program.
4. We suggest looking at the possibility of increasing the number of Master of Science students, by advertising the values of the University on open days in meetings with high school graduates not only in Tirana but also in the districts, through the promotion of the University in various media or various publications.
5. We recommend that the institution promotes and enables the diversification of funding sources for the study program which currently relies mainly on student tuition fees.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

